

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

SKELETKURRIKULI

Për Profilin Mësimor

PRODHIM BIMOR

Niveli II

(Në drejtimin mësimor BUJQËSI)

Kodi. H7-II-18

Miratoi.

MINISTRI

Tiranë, 2018

Përmbajtja.

I. Qëllimet e arsimit profesional në profilin “Prodhim bimor”, niveli II, të drejtimit mësimor “Bujqësi”.

II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në profilin “Prodhim bimor”, niveli II.

1. Kërkesat e pranimet të nxënësve në arsimin profesional në profilin “Prodhim bimor”, niveli II
2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin “Prodhim bimor”, niveli II
3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin “Prodhim bimor”, niveli II
4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit në në profilin “Prodhim bimor”, niveli II.

III. Plani mësimor për profilin “Prodhim bimor”, niveli II.

IV. Udhëzime për planin mësimor

V. Udhëzime për procesin mësimor.

VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.

VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit në profilin “Prodhim bimor”, niveli II,

VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.

IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar.

X. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar.

I. Qëllimet e arsimit profesional në profilin “Prodhim bimor”, niveli II, të drejtimit “Bujqësi”.

Qëllimi kryesor i arsimit profesional në profilin “Prodhim bimor” niveli II, të drejtimit “Bujqësi”, është *“zhvillimi i personalitetit të nxënësve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me prodhimin bimor”*. Për të realizuar këtë, shkolla profesionale u krijon nxënësve.

- mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi dhe aftësitë.
- mundësi për të gjithë, për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehjet, qëndrimet dhe vlerat, të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt arsimit e formimit profesional të mëtejshëm.
- mbështetje për t’u njohur me rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për t’i zbatuar ato me rreptësi.
- mbështetje për t’u njohur me teknologjitë e proceset teknologjike bashkëkohore e të perspektivës, që lidhen me kualifikimin profesional përkatës.
- mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, kuriozitetin intelektual dhe profesional, aftësitë sipërmarrëse, si dhe vlerat morale.
- mbështetje për t’u zhvilluar psikologjikisht dhe fizikisht, për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale.
- mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës së punës.

II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në profili “Prodhim bimor”, niveli II

1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në profilin mësimor “Prodhim bimor”, niveli II

Në shkollat që ofrojnë arsimin profesional në profilin mësimor “Prodhim bimor” niveli II, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që.

- kanë mbaruar arsimin profesional në drejtimin mësimor “Bujqësi”, niveli I.
- janë të aftë fizikisht dhe mendërisht të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.
- nëse kanë aftësi të kufizuara, shkolla krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin.

Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë, MFE përgatit udhëzime të veçanta me kritere të posaçme pranimi për këto shkolla.

2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësve në përfundim arsimit në profilin mësimor “Prodhim bimor”, niveli II

Në përfundim të arsimit profesional në profilin profesional “Prodhim bimor”, niveli II, nxënësi do të zotërojë këto kompetenca të përgjithshme kryesore.

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.

- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më efçente.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt procesin e të nxënës të tij dhe të shfaqë gadishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.

3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin mësimor “Prodhim bimor”, niveli II.

Në përfundim të arsimit profesional në profilin profesional “Prodhim bimor”, niveli II, nxënësi do të jetë i aftë të zhvillojë më tej kompetencat profesionale të fituara në nivelin I, si dhe të ushtrojë kompetenca të tjera profesionale, si më poshtë.

- Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike që lidhen me veprimtaritë profesionale të prodhimit bimor.
- Të bëjë organizimin e vogël të punës në punimet që lidhen me prodhimin bimor.
- Të interpretojë, plotësojë dhe përgatisë dokumentacionin teknik të prodhimit bimor.
- Të përdorë dhe mirëmbajë veglat, pajisjet dhe materialet e punës të prodhimit bimor.
- Të zbatojë planin shëndetësor të bimëve.
- Të zbatojë planin e prodhimit të bimëve në fushë.
- Të vlerësojë materialin bimor për prodhimtari.
- Të zbatojë standardet e profesionit gjatë kryerjes së punimeve dhe shërbimeve në prodhimin bimor.
- Të zbatojë rregullat e sigurisë në punë e të mbrojtjes së mjedisit gjatë kryerjes së punëve dhe shërbimeve në prodhimin bimor.

III. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit profesional në profilin mësimor “Prodhim bimor”, niveli II.

Përfundimi me sukses i arsimit profesional në profilin “Prodhim bimor”, niveli II, e pajis nxënësin me certifikatën e punonjësit të kualifikuar në këtë profil profesional. Ky arsimim i jep mundësi nxënësit t’i drejtohet tregut të punës për t’u punësuar në ndërmarrje publike ose biznese private të prodhim bimore, ferma të ndryshme të prodhimeve bujqësore, si dhe për t’u vetëpunësuar në veprimtari që lidhen me prodhimin bimor. Mbas një përvoja pune dhe trajnimeve të mëtejshme, ai mund të krijojë një biznes të vogël në punimet dhe shërbimet që kryhen në fushën e prodhim bimor dhe të punësojë të tjerë në të.

Me përfundimin e këtij niveli, nxënësi ka mundësi për vazhdimin e arsimimit në nivelin III (teknik/manaxherial) të arsimit profesional (njëvjeçar) në drejtimin/profilin përkatës, për të fituar diplomën e “Maturës shtetërore profesionale”, me mundësi për vazhdimin e studimeve universitare dhe pas të mesmes.

IV. Plani mësimor për arsimin profesional në profilin mësimor “Prodhim bimor”, niveli II

Plani mësimor për profilin mësimor “Prodhim bimor”, niveli II			
Nr	Kodi	Lëndët dhe modulet mësimore	Orët javore/vjetore
			Klasa 12
A.		Lëndët e përgjithshme (Gjithsej)	8/9 (272/306)
1		Gjuhë shqipe	1
2		Letërsi	1
3		Gjuhë e huaj e parë	2
4		Gjuhë e huaj e dytë (me zgjedhje të lirë)	(1)
5		Matematikë	2
6		TIK	1
7		Edukim fizik, sporte, shëndet	1
B.		Lëndët profesionale (Gjithsej)	7 (238)
1	L-17-157-10	Bazat e sipërmarrjes	2
2	L-14-331-13	Agroteknologji e kulturave të arave	3
3	L-14-189-13	Mbrojtje e kulturave të arave	1
4	L-14-332-13	Përpunim i prodhimit bimor	1
C.		Module të detyruar të praktikës profesionale (Gjithsej)	12 (408)
1	M-14-942-13	Përdorim i veglave dhe mjeteve të prodhimit bimor	102
2	M-14-943-13	Zbatim i planit shëndetësor të bimëve	102
3	M-14-944-13	Zbatim i planit të prodhimit bimor në fushë	120
4	M-14-945-13	Vlerësimi i materialit bimor për prodhimtari	84
D.		Modulet e praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar (Gjithsej)	3 (102)
1	M-14-946-13	Analizim i cilësive të farës për mbjellje	51
2	M-08-026-08	Përpunimi i farave të lulediellit për prodhimin e vajit	51
3	M-14-947-13	Ujitje e bimëve të arave dhe perimeve	51
		Gjithsej A+B+C+D	30/31 (1020/ 1054)

IV. Udhëzime për planin mësimor

Në klasën 12, viti shkollor ka gjithsej 36 javë (34 javë mësimore + 2 javë provime)

Një javë mësimore ka jo më shumë se 32 orë mësimore (teorike dhe praktike).

Një orë mësimore zgjat 45 minuta.

Kurrikuli i arsimit profesional në profilin “Prodhim bimor”, niveli II, përbëhet nga 4 grupe elementesh kurrikulare.

- Lëndët e kulturës së përgjithshme, të përbashkëta për profilet e ndryshme të këtij niveli (programet e detajuara të tyre jepen në një dokument të veçantë të MASR).

- Lëndët e kulturës profesionale (programet e përgjithëshme janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale të detyruara (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale me zgjedhje të detyruar (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).

Rekomandohet që modulet e praktikës profesionale të realizohen në ndarje ditore 3 orëshe ose 6 orëshe.

V. Udhëzime për procesin mësimor.

Mësuesit e lëndëve teorike profesionale dhe instruktorët e moduleve të praktikave profesionale duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënit aktiv të nxënësve dhe të çojnë në krijimin e ta, të kompetencave të punës, të plota dhe të qëndrueshme.

E rëndësishme është që *planifikimi i mësimdhënies* të bazohet në një proces analize fillestare, i cili të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, niveli i hyrjes së nxënësve, përmbajtja e hollësishme e lëndëve profesionale dhe e moduleve të praktikave profesionale të parashikuara dhe shkalla e integritit të tyre, objektivat konkretë që do të arrihen, mundësitë reale që ka shkolla për realizimin e veprimtarive mësimore etj. Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i të gjithë personelit mësimdhënës dhe drejtues të shkollës.

Elementi kyç për arritjen e suksesit në një proces të nxëni, është *motivimi i nxënësve*. Njohja e vazhdueshme e nxënësve me shkallën e përmbushjes së objektivave nga ana e tyre përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga mësuesit.

Një element tjetër që ndihmon suksesin është *integrimi i teorisë me praktikën* e profesionit. Parimi i “të nxënit duke bërë” duhet të gjejë vendin e duhur në procesin e të mësuarit në shkollat profesionale të profilit mësimor “Prodhim bimor”, niveli II.

Mësuesit dhe instruktorët duhet të përdorin metoda të tilla të të mësuarit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike, shkathtësitë dhe shprehitë praktike të nxënësve, por edhe qëndrimet e tyre ndaj jetës, punës dhe shoqërisë në përgjithësi. *Puna në grup* dhe *Puna me projekte* janë dy nga format bazë të organizimit të mësimin (teorik ose praktik) për të zhvilluar *kompetencat kyçe*, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale në veçanti dhe jetën e profesionistit të ardhshëm, në përgjithësi.

Një parim tjetër që duhet respektuar nga mësuesit dhe instruktorët është fakti që *të nxënit nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre*. Dhënia e detyrave dhe puna kërkimore e pavarur e nxënësve ka një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm të profilit profesional “Prodhim bimor”.

VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.

Vlerësimi vjetor i nxënësve në lëndët teorike profesionale dhe modulet e praktikave profesionale bëhet nga vetë mësuesit dhe instruktorët përkatës, me metoda dhe instrumente vlerësimi të përgatitura ose përzgjedhura nga vetë ata. Vlerësimi i nxënësve të bëhet me nota (4-10) si për lëndët teorike, ashtu edhe për modulet praktike, si gjatë vitit, ashtu edhe në provimet përfundimtare.

Në përfundim të klasës së 12-të, nxënësi i arsimuar në profilin mësimor “Prodhim bimor”, niveli II, i nënshtrohet provimeve të mëposhtme.

- Provimi i teorisë profesionale të integruar.
- Provimi i praktikës profesionale të integruar.

Në këto provime ata vlerësohen për shkallën e përvetësimit të kompetencave profesionale

(njohurive, shprehive, vlerave dhe qëndrimeve), të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale që operojnë në fushën e ndërtimit, dhe u jepet certifikata në të cilën evidentohen notat përfundimtare të lëndëve teorike profesionale, të moduleve të praktikës profesionale, të lëndëve të përgjithshme, si dhe rezultatet e dy provimeve përfundimtare të nivelit II.

VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në profilin mësimor “Prodhim bimor”, niveli II

Me përfundimin e suksesshëm të arsimit profesional në profilin mësimor “Prodhim bimor”, niveli II, shkolla profesionale e pajis nxënësin me Dëftesën e përfundimit të këtij niveli si dhe me Certifikatën e aftësisimit profesional, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas modelit të miratuar nga MFE, këto dëshmi përmbajnë.

a) Të dhënat për nxënësin, shkollën, vitin e përfundimit, kualifikimin e fituar, etj.

b) Të dhëna për rezultatet e arritura nga nxënësi.

- rezultatet në lëndët e përgjithshme, lëndët profesionale dhe modulet profesionale,

- rezultatet e dy provimeve përfundimtare të Nivelit II.

VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.

1. Lënda “Bazat e sipërmarrjes” (L-17-157-10). Kl. 12 – 68 orë

- Synimet e lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl. 12.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.12, nxënësit duhet.

- Të shpjegojnë sipërmarrjen me të gjithë elementët kryesorë të saj
- Të shpjegojnë lidhjen midis sipërmarrjes dhe veprimtarisë njerëzore
- Të shpjegojnë ndikimin e sipërmarrjes në biznes
- Të shpjegojnë funksionet themelore të organizimit të punës në biznes
- Të përshkruajnë veçoritë e tregut dhe veprimtaritë që kryhen në të
- Të përshkruajnë llojet e konsumatorëve, kërkesat specifike për mallra/sherbime dhe reagimet e tyre ndaj sinjaleve të marketingut të një sipërmarrjeje
- Të shpjegojnë kuptimin e institucioneve financiare dhe rolin e tyre në biznes
- Të shpjegojnë kuptimin e bankave dhe shërbimet e tyre
- Të shpjegojnë kuptimin, rëndësinë, mjetet dhe strategjitë e marketingut
- Të listojnë katër *P*-të e marketingut
- Të përshkruajnë konceptet bazë të legjislacionit dhe etikës së biznesit.
- Të shpjegojnë rëndësinë e legjislacionit të punës dhe elementet përbërës të tij.
- Të kryejnë llogaritje të thjeshta ekonomike të një aktiviteti sipërmarrës
- Të shpjegojnë rëndësinë, nevojën dhe aspektet kryesore të përdorimit të Teknologjisë së Informimit dhe Komunikimit (TIK) për krijimin e kontakteve në biznes.

- Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.12 - 68 orë

Tema 1	Njohuri të përgjithshme mbi sipërmarrjen	3 orë
Tema 2	Sipërmarrja dhe aktiviteti njerëzor	4 orë
Tema 3	Sipërmarrja dhe biznesi	8 orë
Tema 4	Organizimi i punës në biznes	9 orë
Tema 5	Tregu dhe sjellja konsumatore	6 orë
Tema 6	Institucionet financiare	7 orë
Tema 7	Njohuri për Marketingun	5 orë
Tema 8	Legjislacioni dhe etika e biznesit	5 orë
Tema 9	Legjislacioni i punës	7 orë
Tema 10	Llogaritje të thjeshta ekonomike	10 orë
Tema 11	Aspekte të TIK-ut në biznes	4 orë

2. Lënda “Agroteknologji e kulturave të arave ” (L-14-331-13). Kl. 12 – 102 orë

- Synimet e lëndës “Agroteknologji e kulturave të arave”, kl. 12.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Agroteknologji e kulturave të arave”, kl.12, nxënësit duhet.

- të përshkruajnë vlerat ekonomike dhe rëndësinë që ka prodhimi bimor në ekonominë e vendit.

- të bëjnë dallimin midis sistemeve të ndryshme si. sistemi natyral, tradicional, intensiv, dhe organik i prodhimit bimor.
- të përshkruajnë strukturën, karakteristikat e kultivarëve të grurit, si dhe veçoritë e kultivimit të grurit sipas zonave klimatiko-tokësore.
- të përshkruajnë rolin dhe qëllimet e prodhimit të thekrës, elbit dhe tërshërës në ditët e sotme.
- të përshkruajnë veçoritë e prodhimit të tritikaleve, tepës dhe okrës.
- të përshkruajnë strukturën e hibrideve të misrit, karakteristikat e tyre dhe veçoritë e kultivimit të tyre sipas zonave klimatiko-tokësore.
- të përshkruajnë agroteknologjinë e kultivimit të misrit hamullor.
- të theksojnë momentet kryesore të agroteknologjisë së kultivimit të orizit.
- të përshkruajnë strukturën e bishtajoreve për kokërr, llojet e fasules që kultivohen në vendin tonë.
- të përshkruajnë kultivimin e fasules për kokërr sipas zonave klimatiko-tokësore në vendin tonë, si dhe mënyrat e kultivimit të fasules të bashkëshoqëruar.
- të përshkruajnë veçoritë e kultivimit të sojës krahasuar me fasulën.
- të përshkruajnë veçoritë e kultivimit të bathës, bixelës, qiqrës dhe thjerrëzës.
- të përshkruajnë veçoritë e kultivimit të bimëve industriale vajore si luledielli, kikiriku, recini dhe susami.
- të përshkruajnë veçoritë e kultivimit të bimëve industriale sheqerore si panxhari i sheqerit.
- të përshkruajnë tipet, llojet, karakteristikat e llojeve , cilësitë fiziko-kimike të duhanit dhe veçoritë e kultivimit të tij sipas zonave klimatiko-tokësore.
- të përshkruajnë mënyrat e tharjes dhe të manipulimit të prodhimit të duhanit.
- të përshkruajnë veçoritë e kultivimit të bimëve industriale fijore si pambuku, liri dhe kërpi.
- të përshkruajnë qëllimin e kultivimit, klasifikimin e bimëve aromatike, sipas përdorimit dhe ndikimin e faktorëve mjedisor në prodhimin e tyre.
- të përshkruajnë procesin e mbledhjes, tharjes dhe përpunimit paraprak të bimëve aromatike.
- të përshkruajnë bimët aromatike kryesore që përdoren në farmaceutikë si angjelika, bar blete, valeriana, kamomili, luletogëza, timusi, pelini, trëndafili i egër etj.
- të përshkruajnë bimët aromatike kryesore që përdoren për erëza si rigoni, trumëza, koriandri, anisi, barbaroza, borziloku, menta, shëngjini etj.
- të përshkruajnë bimët aromatike kryesore që përdoren në kozmetikë si lavanda, trëndafili i damaskut etj.
- të krahasojnë veçoritë e kultivimit të kulturave perimore kryesore për frute sipas grup familjeve.
- të krahasojnë veçoritë e kultivimit të kulturave perimore kryesore për gjethe dhe kërcell sipas grup familjeve.
- të krahasojnë veçoritë e kultivimit të kulturave perimore kryesore për frutrrënjor sipas grup familjeve.
- të krahasojnë veçoritë e kultivimit të kulturave perimore kryesore për lule si lulelakra, brokoli.
- të krahasojnë veçoritë e kultivimit të kulturave perimore kryesore për bishtajë si mashurka, batha, vinja etj.

- të përshkruajnë kultivarët e patates që mbillen në vendin tonë, veçoritë e kultivimit sipas zonave, mbjelljen verore të saj, degjenerimin e patates, si dhe mënyrat e ruajtjes së prodhimit të patates.
- të hartojnë vargëzimin e prodhimit perimor për gjatë gjithë vitit.
- të vlerësojnë anën ekonomike e bujqësore të prodhimit foragjer në vendin tonë.
- të përshkruajnë veçoritë e rritjes së kulturave foragjere, sipas grupeve të bimëve të prodhimit foragjer.
- të përshkruajnë karakteristikat e prodhimit foragjer të kulturave kryesore gramore një dhe shumëvjeçare si melakuqi, tërshëra, elbi, thekra, egjrat, telishi, bishtpelëzat, bishtmiu livadhlor, bishtdhelpra livadhlore, kokëmadhja, bar mali ose xhufka, flokëzat.
- të përshkruajnë karakteristikat e prodhimit foragjer të kulturave kryesore bishtajore një dhe shumëvjeçare si tërfili gushtak, soja, batha, koçkulla, urovi, lupini i ëmbël ose i bardhë, buxhaku, bizelja foragjere, jonxha e kaltër, barhëndëza, tërfili livadhlor, tërfili i bardhë etj.
- të përshkruajnë teknologjinë e prodhimit të farës së grurit, misrit, duhanit, patates, domates, specit, qepës dhe jonxhës.
- të përshkruajnë veçoritë e aproimit të farës në përgjithësi, si dhe të kulturave në veçanti.
- të analizojë cilësitë e farës në kushte laboratorike si. pastërtia mekanike dhe biologjike, peshat specifike, fuqia dhe energjia mbirëse etj.
- të vlerësojnë kulturat bujqësore për prodhimtari, për qëndrueshmëri ndaj thatësisës, të ftohtit, rrëzimit dhe shkoqjes, sëmundjeve e dëmtuesve etj.
- të përshkruajnë parimet dhe mënyrat e ruajtjes së prodhimit bimor.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Agroteknologjia e kulturave të arave”, kl 12 - 102 orë**

Tema 1	Rëndësia dhe sistemet e prodhimit bimor	2 orë
	<i>Për drithërat e lashta</i>	
Tema 2	Veçoritë e prodhimit të grurit	2 orë
Tema 3	Veçoritë e prodhimit të thekrës, elbit dhe tërshërës	6 orë
Tema 4	Veçoritë e prodhimit të tritikaleve, tepës dhe okrës	4 orë
	<i>Për drithërat e vona</i>	
Tema 5	Veçoritë e prodhimit të misrit	4 orë
Tema 6	Njohuri për prodhimin e orizit	2 orë
	<i>Për kulturat bishtajore për kokërr</i>	
Tema 7	Veçoritë e prodhimit të fasules	2 orë
Tema 8	Veçoritë e prodhimit të sojës	2 orë
Tema 9	Veçoritë e prodhimit të bathës e bizelës	2 orë
Tema 10	Veçoritë e prodhimit të qiqrës e thjerrëzës	2 orë
	<i>Për kulturat industriale</i>	
Tema 11	Veçoritë e prodhimit të kulturave vajore	2 orë
Tema 12	Veçoritë e prodhimit të kulturave sheqerore	4 orë
Tema 13	Veçoritë e prodhimit të kulturave narkotike	4 orë
Tema 14	Veçoritë e prodhimit të kulturave fijore	4 orë
Tema 15	Veçoritë e prodhimit të kulturave aromatike	8 orë
	<i>Për kulturat perimore</i>	
Tema 16	Veçoritë e prodhimit të kulturave perimore për frute	3 orë

Tema 17	Veçoritë e prodhimit të kulturave perimore për gjethe dhe kërcell	3 orë
Tema 18	Veçoritë e prodhimit të kulturave perimore për fruttrënjor	3 orë
Tema 19	Veçoritë e prodhimit të kulturave perimore për lule	3 orë
Tema 20	Veçoritë e prodhimit të kulturave perimore për bishtajë	2 orë
Tema 21	Veçoritë e prodhimit të patates. Degjernerimi i patates. Ruajtja e prodhimit të patates	6 orë
Tema 22	Vargëzimi i prodhimit të perimeve	2 orë
	<i>Për kulturat foragjere</i>	
Tema 23	Veçoritë e prodhimit foragjer	2 orë
Tema 24	Bimët foragjere gramore një dhe shumëvjeçare	3 orë
Tema 25	Bimët foragjere bishtajore një dhe shumëvjeçare	3 orë
	<i>Për prodhimin e farës së bimëve bujqësore</i>	
Tema 26	Veçoritë e agroteknikës së prodhimit të farës	2 orë
Tema 27	Prodhimi i farës së grurit	2 orë
Tema 28	Prodhimi i farës hibride të misrit dhe linjave	2 orë
Tema 29	Prodhimi i farës së domates, qepës dhe prazit	2 orë
Tema 30	Prodhimi i farës së jonxhës	2 orë
Tema 31	Veçoritë e aprobimit të farës për kultura të ndryshme bujqësore	2 orë
Tema 32	Cilësitë e farës	2 orë
Tema 33	Vlerësimi i kulturave bujqësore	4 orë
Tema 34	Ruajtja e prodhimeve bimore	4 orë

3. Lënda “Mbrotjtje e kulturave të arave” (L-14-189-13). Kl. 12 – 34 orë

- **Synimet e lëndës “Mbrotjtje e kulturave të arave”, kl. 12.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Mbrotjtje e kulturave të arave”, kl.12, nxënësit duhet.

- të përshkruajnë rolin, qëllimin dhe rëndësinë e mbrotjtjes të bimëve në vendin tonë.
- Të tregojnë vlerësimin ekonomik të dëmeve të shkaktuara nga sëmundjet dhe dëmtuesit e bimëve.
- të përkufizojnë ç’janë sëmundjet e bimëve bujqësore dhe si klasifikohen ato.
- Të përcaktojnë faktorët abiotik (pa jetë) dhe biotik (me jetë) si shkaktarë të sëmundjeve të ndryshme.
- Të përshkruajnë se ç’janë viruset, përbërjen e tyre dhe tiparet e sëmundjeve virusale.
- Të përshkruajnë ndërtimin, biologjinë dhe klasifikimin e bakterieve fitopatogjene si dhe shenjat e sëmundjeve bakteriale.
- Të shpjegojnë mënyrat e shumimit, ciklit jetësor të kërpudhave, klasifikimin dhe veçantitë e çdo klase.
- Të shpjegojnë sëmundjen si proces patologjik, fazat, mënyrat e përhapjes së sëmundjeve, diagnostikimin dhe qëndrueshmërinë (imunitetin) e bimëve ndaj sëmundjeve.
- Të përshkruajnë ndërtimin, biologjinë dhe dëmet që shkaktajnë nematodat, kërmintë, këpushat, si dhe masat e luftimit ndaj tyre.
- Të tregojnë ndërtimin e insekteve (kandrrave), ndryshimet e aparateve gojore, ciklin e zhvillimit, mënyrat e riprodhimit dhe metamorfozat.
- Të tregojë klasifikimin e insekteve, dallimet midis rendeve dhe dëmet vlerësuese të shkaktuara nga dëmtuesit e kulturave bujqësore.

- Të identifikojnë rolin e faktorëve ekologjikë në zhvillimin dhe shumimin e parazitëve dhe dëmtuesve.
- Të analizojnë metodat e vrojtimit, të prognozimit e të sinjalizimit të sëmundjeve dhe të dëmtuesve.
- Të përshkruajnë metodat e ndryshme të luftimit të sëmundjeve dhe dëmtuesve të kulturave bujqësore.
- Të përshkruajnë preparatet kryesore kryesore aktuale që përdoren për luftimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve.
- Të theksojnë rregullat e përdorimit të ruajtjes së preparateve kimike, si dhe të dhënies së ndihmës së parë në rast rreziku.
- Të tregojë si është i organizuar shërbimi i mbrojtjes së bimëve në komunë dhe legjislacionin ekzistues.
- Të tregojë përhapjen, përshkrimin, shenjat e dëmtimit dhe masat e luftimit ndaj sëmundjeve e dëmtuesve polifage në kulturat bujqësore.
- Të përshkruajnë karakteristikat kryesore të sëmundjeve dhe dëmtuesve të drithërave, si dhe masat e luftimit ndaj tyre
- Të përshkruajnë sëmundjet dhe dëmtuesit e patates, perimeve e bimëve bishtajore si dhe masat e luftimit ndaj tyre.
- Të përshkruajnë specifikat e sëmundjeve dhe dëmtuesve kryesorë të bimëve industriale, si dhe masat e luftimit ndaj tyre sipas kushteve të zonës apo rajonit.
- Të përshkruajnë disa nga dëmtuesit e prodhimeve të ruajtura në depo dhe masat efektive të luftës ndaj tyre.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Mbrojtje e kulturave të arave”, kl 12 - 34 orë**

Tema 1	Mbrojtja e bimëve si shkencë, rëndësia e saj	2 orë
Tema 2	Bima e kultivuar si objekt i mbrojtjes së bimëve	3 orë
Tema 3	Dëmtuesit e kulturave bujqësore	6 orë
Tema 4	Faktorët ekologjik dhe metodat e luftimit të sëmundjeve e dëmtuesve, preparatet kryesore	5 orë
Tema 5	Shërbimi i mbrojtjes së bimëve në vendin tonë dhe legjislacioni për përdorimin dhe ruajtjen e preparative	2 orë
Tema 6	Dëmtuesit dhe sëmundjet polifage	3 orë
Tema 7	Sëmundjet dhe dëmtuesit e drithërave	3 orë
Tema 8	Sëmundjet dhe dëmtuesit e patates, perimeve dhe bimëve bishtajore	5 orë
Tema 9	Sëmundjet dhe dëmtuesit e bimëve industriale	3 orë
Tema 10	Dëmtuesit e prodhimeve në depo	2 orë

4. Lënda “Përpunim i prodhimit bimor” (L-14-332-13) Kl.12 – 34 orë

• **Synimet e lëndës “Përpunim i prodhimit bimor”, kl. 12.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Përpunim i prodhimit bimor”, kl.12, nxënësit duhet.

- Të theksojnë rëndësinë ekonomike të përpunimit e ruajtjes së produkteve bujqësore me origjinë bimore.
- Të përshkruajnë cilësitë, klasifikimin, mjetet dhe teknologjinë e përpunimit e të ruajtjes së produkteve të drithërave.

- Të përshkruajnë cilësitë, përbërjen kimike të perimeve që përdoren si lëndë e parë në industrinë e përpunimit.
- Të përshkruajnë rëndësinë, mjetet dhe teknologjinë e përpunimit të perimeve për salcë, turshi etj.
- Të tregojnë mënyrat e ambalazhimit e të ruajtjes së prodhimeve të përpunuara të perimeve.
- Të përshkruajnë cilësitë, përbërjen kimike të bimëve vajore që përdoren si lëndë e parë në industrinë e përpunimit.
- Të përshkruajnë rëndësinë, mjetet dhe teknologjinë e përpunimit të bimëve vajore.
- Të tregojnë mënyrat e ambalazhimit, etiketimit e të ruajtjes së prodhimeve të përpunuara të bimëve vajore.
- Të përshkruajnë mënyrat e përpunimit të prodhimit foragjer si ushqim për blegtorinë.
- Të përshkruajnë mënyrat e ruajtjes së prodhimit foragjer të përpunuar.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Përpunim i prodhimit bimor”, kl 12 - 34 orë**

Tema 1	Rëndësia e përpunimit dhe e ruajtjes të prodhimit bimor	3 orë
Tema 2	Përpunimi i drithrave	6 orë
Tema 3	Ambalazhimi, etiketimi dhe ruajtja e produkteve të përpunuara të drithrave	3 orë
Tema 4	Përpunimi i perimeve	5 orë
Tema 5	Ambalazhimi etiketimi dhe ruajtja e produkteve të përpunuara të perimeve	3 orë
Tema 6	Përpunimi i bimëve vajore	5 orë
Tema 7	Ambalazhimi, etiketimi dhe ruajtja e produkteve të përpunuara të bimëve vajore	3 orë
Tema 8	Përpunimi i prodhimit foragjer për blegtori	4 orë
Tema 9	Ruajtja e prodhimit foragjer të përpunuar	2 orë

IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar

1. Moduli “Përdorim i veglave dhe mjeteve të prodhimit bimor”

Drejtimi.	Bujqësi
Profili.	Prodhim bimor
Niveli.	II
Klasa.	12

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	PËRDORIM I VEGLAVE DHE MJETEVE TË PRODHIMIT BIMOR	M-14-942-13
Qëllimi i modulit	Modul praktik që i pajis nxënësit me aftësi praktike për të përzgjedhur, përdorur dhe mirëmbajtur një larmi veglash dhe mjeteve të prodhimit bimor, si dhe të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me to.	
Kohëzgjatja e modulit	102 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të kualifikimit në drejtimin mësimor “Bujqësi”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi përzgjedh veglat dhe mjetet e prodhimit bimor në fermë.</p> <p>Përmbajtja.</p> <ul style="list-style-type: none">– Përzgjedhja e llojit të shtytjes /tërheqjes së veglave e pajisjeve për kryerjen e punimeve dhe shërbimeve të prodhimit bimor.– Përzgjedhja e veglave të dorës për kryerjen e punimeve dhe shërbimeve të prodhimit bimor.– Përzgjedhja e veglave apo pajisjeve motorike për kryerjen e punimeve dhe shërbimeve të prodhimit bimor.– Përzgjedhja e pajisjeve/agrgatëve që i bashkëngjiten mjetit shtytës/tërheqës të prodhimit bimor. <p>Instrumentet e vlerësimit.</p> <ul style="list-style-type: none">– Diskutim– Pyetje-përgjigje me gojë– Vëzhgim me listë kontrolli <p>Kriteret e vlerësimit.</p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë.</p> <ul style="list-style-type: none">– Të përzgjedhë llojin e duhur të shtytjes/tërheqjes së veglave e mjeteve për kryerjen e punimeve dhe shërbimeve të prodhimit bimor si. traktor, kafshë, krah pune, në përputhje me kushtet lokale.– Të përzgjedhë veglat e dorës të nevojshme për kryerjen e punimeve dhe shërbimeve të prodhimit bimor, sipas llojit	

të procesit të punës dhe të kulturës, të tilla si. shat i thjeshtë, shat mbjellës, cap-prashitëse, cfurk, drapër, krëhër, lopatë, bel, kazëm, gërshërë krasitëse, veglat e shartimit, lidhësa të llojeve të ndryshme, grabujë, hanxharë, sharrë, sëpatë etj.

- Të përpërzgjedhë veglat apo pajisjet e duhura motorike të prodhimit bimor, sipas tipit të tokës, llojit të procesit të punës dhe kulturës, kushteve të zonës etj., të tilla si. traktor, kultivator, motor pompë, spërkatës, makinë korrëse, makinë shirëse etj..
- Të përpërzgjedhë pajisjet/agregatët e duhura që tërhiqen me traktor ose me kafshë, sipas tipit të tokës, llojit të procesit të punës, kushteve të zonës etj., të tilla si., plugu, disku, freza, lesa, kultivatori etj..

RM 2 Nxënësi përdor veglat dhe mjetet e punës të prodhimit bimor në fermë.

Përmbajtja.

- Kontrolli teknik i veglave dhe mjeteve të punës.
- Përshtatja e veglave dhe mjeteve të ndryshme të punës.
- Përdorimi i veglave dhe mjeteve ndryshme të punës.
- Pastrimi i veglave dhe mjeteve të ndryshme të punës pas përdorimit.
- Rregjistrimi i të dhënave të përdorimit të veglave dhe mjeteve të punës të prodhimit bimor.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë përdorimit të veglave dhe mjeteve të prodhimit bimor.

Instrumentet e vlerësimit.

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit.

Nxënësi duhet të jetë i aftë.

- Të kryejë kontrollin teknik vizual të zakonshëm veglave dhe mjeteve të punës të prodhimit bimor, sipas procedurës teknike të kontrollit.
- Të bëjë përshtatjen e veglave dhe mjeteve të punës sipas parametrave të duhur teknik të llojit të punimit, si thellësia, distancat, montime, mprehje etj..
- Të përdorë me krah, mjete mekanike apo me kafshë pune, vegla dhe pajisje të ndryshme të punës të prodhimit bimor, sipas llojit të procesit të punës dhe kushteve lokale të zonës.
- Të pastrojë veglat dhe mjetet e punës pas përdorimit të tyre në përputhje me procedurën fikse të pastrimit.
- Të rregjistrojë saktë të dhënat e përdorimit të veglave dhe mjeteve të punës të prodhimit bimor sipas zëra të kërkuar.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë përdorimit të veglave dhe mjeteve të prodhimit bimor.

RM 3 Nxënësi mirëmban veglat dhe mjetet e punës të prodhimit bimor.

Përmbajtja.

- Hartimi i planit të kryerjes së shërbimeve të mirëmbajtjes së veglave dhe mjeteve të prodhimit bimor.
- Identifikimi i shërbimeve të mirëmbajtjes të nevojshme për veglat dhe mjetet e punës të prodhimit bimor.
- Kryerja e shërbimeve të mirëmbajtjes të veglave e pajisjeve të punës të prodhimit bimor.
- Identifikimi i defekteve, konsumimit dhe dëmtimeve të veglave e mjeteve të ndryshme të punës të prodhimit bimor.
- Kryerja e riparimeve bazë e veglave dhe mjeteve të punës të prodhimit bimor.
- Kujdesi dhe ruajtja e veglave dhe mjeteve të punës të prodhimit bimor.
- Rregjistrimi i të dhënave të shërbimeve të mirëmbajtjes së veglave dhe mjeteve të punës së prodhimit bimor.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë kryerjes së shërbimeve të mirëmbajtjes së veglave e mjeteve të prodhimit bimor.

Instrumentet e vlerësimit.

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit.

Nxënësi duhet të jetë i aftë.

- Të hartojë planin e kryerjes së shërbimeve të mirëmbajtjes së veglave dhe mjeteve të prodhimit bimor, sipas llojit të shërbimit, kohës dhe cilësisë së kryerjes së tyre.
- Të identifikojë shërbimet e nevojshme të mirëmbajtjes së veglave dhe mjeteve të punës të prodhimit bimor.
- Të kryejë shërbimet e mirëmbajtjes së veglave e mjeteve të punës të prodhimit bimor, sipas planit paraprak.
- Të bëjë saktë identifikimin e defekteve, konsumimit dhe dëmtimeve të veglave e mjeteve të ndryshme të punës të prodhimit bimor.
- Të kryejë riparimeve të thjeshta bazë të veglave dhe pajisjeve të punës të prodhimit bimor të tilla si. çmontim-montim, mprehje, shtrëngim vidash, ndërrim bishti të veglave etj..
- Të kujdeset siç duhet për veglat dhe pajisjet e punës të prodhimit bimor gjatë kohës ë ruajtjes së tyre në depo apo magazinë.
- Të bëjë saktë rregjistrimet e të dhënave përkatëse të shërbimeve të mirëmbajtjes së veglave dhe mjeteve të punës së prodhimit bimor, sipas zërave të kërkuar.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë kryerjes së shërbimeve të mirëmbajtjes së veglave e pajisjeve të prodhimit bimor.

RM 4 Nxënësi kryen llogaritje të thjeshta ekonomike të përdorimit dhe mirëmbajtjes së veglave dhe mjeteve të ndryshme të prodhimit bimor.

Përmbajtja

- Kostot e përdorimit dhe të mirëmbajtjes së veglave dhe mjeteve të ndryshme të prodhimit bimor, si dhe përbërësit e kostove.
- Preventivi i materialeve, kostoja për materialet.
- Kostoja e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.).
- Kosto të tjera (transport dhe makineri).
- Të ardhurat, fitimi, llogaritja e fitimit në një biznes të vogël të mirëmbajtjes së veglave dhe mjeteve të prodhimit bimor.

Instrumentet e vlerësimit.

- Pyetje-përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit.

Nxënësi duhet të jenë të aftë.

- të njehsojë kostot e përdorimit të veglave dhe mjeteve të prodhimit bimor.
- të njehsojë preventivin e materialeve dhe koston e tyre, sipas manualit përkatës.
- të njehsojë koston e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.), sipas manualit përkatës.
- të njehsojë kostot e tjera (transport dhe makineri), sipas manualit përkatës.
- të llogarisë të ardhurat dhe fitimin në një biznes të vogël për përdorimin dhe mirëmbajtjen e veglave dhe mjeteve të prodhimit bimor.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul mund të trajtohet në fermën e shkollës ose në ndonjë fermë, pranë shkollës sipas mundësive që ofron zona dhe rajoni ku ndodhet ajo.
- Gjatë trajtimit të modulit mësuesi i praktikës duhet të përdorë demostrime konkrete të përzgjedhjes, përdorimit dhe mirëmbajtjes së veglave dhe mjeteve të prodhimit bimor, si dhe të llogaritjeve të thjeshta ekonomike lidhur me to.
- Instruktori i praktikës mund të organizojë edhe vizitë mësimore në ferma të prodhimit bimor apo në pika servisi të makinerive bujqësore, që nxënësit të njihen konkretisht me larminë e tyre dhe me metodat e thejshta të riparimeve bazë të tyre.
- Instruktori i praktikës përfshin nxënësit në diskutim mbi përzgjedhjen, përdorimin dhe mirëmbajtjen e veglave dhe mjeteve të prodhimit bujqësor.
- Nxënësit duhet të praktikohen sa më shumë të jetë mundur në përzgjedhjen, përdorimin dhe mirëmbajtjen e veglave dhe mjeteve të prodhimit bimor, si dhe në llogaritjet e thjeshta ekonomike lidhur me to.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë përdorimin dhe

mirëmbajtjen e veglave dhe mjeteve gjatë dhe pas kryerjes së punimeve për prodhimin bimor.

- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë përdorimit dhe mirëmbajtjes së veglave dhe mjeteve të prodhimit bimor.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, të përzgjedhjes, përdorimit dhe mirëmbajtjes së veglave e mjeteve të punës të prodhimit bimor, si dhe të llogaritjeve të thjeshta ekonomike lidhur me to.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme.

- Ferma e shkollës.
 - Traktor, kafshë pune.
 - Veglat dhe mjetet e punimit të tokës.
 - Veglat dhe mjetet e mbjelljes së bimëve.
 - Veglat dhe mjetet e përkujdesjes ndaj bimëve.
 - Veglat dhe mjetet e vjelje/korrjes së prodhimit bimor.
 - Material mbjellës si. fara, fidanë, copa, bulbe etj.
 - Mjetet dhe instrumentet e piktimit.
 - Pankarta, udhëzues, katalogë, rregullore, standarde të prodhimit bimor.
 - Pajisje kancelarie.
 - Makina llogaritëse dore.
 - Manualet e preventivimit dhe të zbërthimit e kostos.
 - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e punimeve të prodhimit bimor (kodi i punës, legjislacioni fiskal).
 - Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal.
-

2. Moduli “Zbatimi i planit shëndetësor të bimëve”

Drejtimi.	Bujqësi
Profili.	Prodhim bimor
Niveli.	II
Klasa.	12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	ZBATIMI I PLANIT SHËNDETËSOR TË BIMËVE	M-14-943-13
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për të kryer punime të kontrollit të shëndetit të bimëve, zbatimit të masave mbrojtëse të shëndetit të bimëve ndaj sëmundjeve, dëmtuesve dhe barishteve të këqija, si dhe të llogaritjeve të thjeshta ekonomike që lidhen me këto punime.	
Kohëzgjatja e modulit	102 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor “Bujqësi”, dhe modulën “Përdorim i veglave dhe mjeteve të prodhimit bimor”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi kontrollon gjendjen shëndetësore të bimëve.</p> <p>Përmbajtja.</p> <ul style="list-style-type: none">– Përcaktimi i kulturës bimore për kontroll shëndetësor.– Përcaktimi i fushës ose parcelës për kontroll.– Hartimi i planit të kontrollit “kur, ku dhe çfarë”.– Përcaktimi i qëllimit të kontrollit shëndetësor të bimëve.– Kryerja e kontrollit shëndetësor të bimëve për sëmundje.– Mbajtja shënim i të dhënave nga kontrolli për sëmundje.– Kryerja e kontrollit shëndetësor të bimëve për dëmtues.– Mbajtja shënim e të dhënave nga kontrolli për dëmtues.– Kryerja e kontrollit të fushës apo parcelës për shfaqjen e barishteve të këqija.– Mbajtja shënim e të dhënave nga kontrolli për barishte të këqija.– Përgatitja e raportit përmbledhës të kontrollit shëndetësor të bimëve.– Raportimi mbi gjendjen shëndetësore të bimëve.– Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së kontrollit shëndetësor të bimëve. <p>Instrumentet e vlerësimit.</p> <ul style="list-style-type: none">– Pyetje – përgjigje me gojë.– Vëzhgim me listë kontrolli. <p>Kriteret e vlerësimit.</p> <p>Nxënësi duhet të jenë të aftë.</p>	

-
- Të përcaktojë llojin e kulturës bimore për kontroll shëndetësor, sipas mundësive që ofron zona.
 - Të përcaktojë fushën ose parcelën për kryerjen e kontrollit.
 - Të hartojë planin e kryerjes së kontrollit shëndetësor “kur, ku dhe çfarë”.
 - Të përcaktojë qëllimin e kontrollit shëndetësor të bimëve.
 - Të kryejë kontrollin shëndetësor të bimëve për shfaqje të sëmundjeve sipas planit të hartuar dhe fazave të ndryshme të rritjes dhe zhvillimit të tyre.
 - Të mbajë saktë të dhënat nga kontrolli i bimëve për sëmundje të tilla si. emri i kulturës së kontrolluar, numri i fushës apo parcelës, data e kontrollit, faza e rritjes së bimës, simptomat e shfaqura, lloji i sëmundjes, shkalla e përhapjes së sëmundjes etj..
 - Të kryejë kontrollin shëndetësor të bimëve për shfaqje të dëmtuesve, sipas planit të hartuar dhe fazave të ndryshme të rritjes dhe zhvillimit të tyre.
 - Të mbajë saktë të dhënat nga kontrolli i bimëve për dëmtues, të tilla si. emri i kulturës së kontrolluar, numri i fushës apo parcelës, data e kontrollit, faza e rritjes së bimës, lloji i dëmtuesit, shkalla e përhapjes së dëmtuesve etj..
 - Të kryejë kontrollin e fushës apo parcelës së bimëve për shfaqjen e barishteve të këqija, sipas planit të hartuar dhe fazave të ndryshme të rritjes dhe zhvillimit të tyre.
 - Të mbajë saktë të dhënat nga kontrolli i bimëve për barishte të këqija, të tilla si. emri i kulturës së kontrolluar, numri i fushës apo parcelës, data e kontrollit, faza e rritjes së bimës, lloji i barit të keq, shkalla e përhapjes së barit të keq, niveli i dëmit të shkaktuar etj..
 - Të përgatitë një raport përmbledhës mbi kontrollin shëndetësor të bimëve për sëmundje, dëmtues dhe barishte të këqija.
 - Të raportojë mbi gjendjen shëndetësore të bimëve te personat përgjegjës për mbrojtjes e shëndetit të bimëve.
 - Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së kontrollit shëndetësor të bimëve.

RM 2 Nxënësi zbaton planin e masave mbrojtëse të shëndetit të bimëve.

Përmbajtja.

- Veshja e uniformës së punës për zbatimin e planit të masave mbrojtëse të shëndetit të bimëve.
- Dhënia e udhëzimeve për zbërthimin e planit të masave mbrojtëse të shëndetit të bimëve.
- Zbërthimi i planit të masave mbrojtëse të shëndetit të bimëve.
- Diagnostikimi i llojit të sëmundjes, dëmtuesit dhe barit të

keq.

- Përcaktimi i mjeteve, pajisjeve dhe materialeve për zbatimin e planit të masave mbrojtëse të shëndetit të bimëve.
- Zbatimi i masave mbrojtëse të shëndetit të bimëve ndaj sëmundjeve.
- Zbatimi i masave mbrojtëse të shëndetit të bimëve ndaj dëmtuesve.
- Zbatimi i masave mbrojtëse të shëndetit të bimëve ndaj barishteve të këqija.
- Mbajtja shënim e të gjitha masave të kryera për mbrojtjen e shëndetit të bimëve.
- Pastrimi i mjeteve dhe pasjisjeve të përdorura për mbrojtjen e shëndetit të bimëve.
- Kontrolli i vazhdueshën i shëndetit të bimëve pas zbatimit të planit të masave mbrojtëse.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë zbatimit të masave mbrojtëse të shëndetit të bimëve nga sëmundje, dëmtues dhe barishte të këqija.

Instrumentet e vlerësimit.

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit.

Nxënësi duhet të jenë të aftë.

- Të veshë të gjitha pajisjet e kompletit mbrojtës për zbatimin e planit të masave mbrojtëse të shëndetit të bimëve, sipas llojit të masave që do të zbatohet.
- Të rikujtojë udhëzimet për zberthimin e planit të masave mbrojtëse të shëndetit të bimëve.
- Të zberthejë planin e masave mbrojtëse të shëndetit të bimëve, sipas modeleve të dhëna dhe udhëzimeve përkatëse.
- Të diagnostikojë llojin e sëmundjes, dëmtuesit dhe barit të keq, sipas shenjave të shfaqura në bimë.
- Të përcaktojë mjetet, pajisjet dhe materialet e nevojshme për zbatimin e planit të masave mbrojtëse të shëndetit të bimëve, sipas llojit të kulturës, sëmundjes, dëmtuesit, barishteve të këqija dhe metodës së luftimit të tyre në respekt të plotë mjedisor.
- Të zbatojë masat mbrojtëse të shëndetit të bimëve ndaj sëmundjeve sipas planit paraprak.
- Të zbatojë masat mbrojtëse të shëndetit të bimëve ndaj dëmtuesve, sipas planit paraprak.
- Të zbatojë masat mbrojtëse të shëndetit të bimëve ndaj barishteve të këqijasipas planit paraprak.
- Të mbajë saktë shënimet e të gjitha llojeve masave të kryera për mbrojtjen e shëndetit të bimëve si datën e kryerjes, llojin e sëmundjes, dëmtuesit apo barishteve të këqija, masat e kryera (agroteknike, fiziko-mekanike,

- biologjike, kimike), faza e zhvillimit të bimës, kostot përkatëse etj.
- Të pastrojë siç duhet mjetet dhe pasjiset e përdorura për mbrojtjen e shëndetit të bimëve.
- Të kontrollojë vazhduimisht shëndetin e bimëve pas zbatimit të planit të masave mbrojtëse.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë zbatimit të masave mbrojtëse të shëndetit të bimëve nga sëmundje, dëmtues dhe barishte të këqija.

RM 3 Nxënësit kryejnë llogaritje të thjeshta ekonomike të zbatimit të masave mbrojtëse të shëndetit të bimëve.

Përmbajtja.

- Kostot e punimeve të zbatimit të masave mbrojtëse të shëndetit të bimëve.
- Preventivi i materialeve, kostoja për materialet.
- Kostoja e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.).
- Kosto të tjera (transport dhe makineri).
- Të ardhurat, fitimi, llogaritja e fitimit në punimet e mbrojtjes së shëndetit të bimëve.

Instrumentet e vlerësimit.

- Pyetje-përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit.

Nxënësit duhet të jenë të aftë.

- të njehsojnë kostot e punimeve të zbatimit të masave mbrojtëse të shëndetit të bimëve.
- të njehsojnë preventivin e materialeve dhe koston e tyre, sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë koston e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.), sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë kostot e tjera (transport dhe makineri), sipas manualit përkatës.
- të llogaritin të ardhurat dhe fitimin në punimet e mbrojtjes së shëndetit të bimëve.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në fermën e shkollës në ferma të prodhimit bimor pranë saj.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrime konkrete të zbatimit të masave mbrojtëse të shëndetit të bimëve ndaj sëmundjeve, dëmtuesve dhe barishteve të këqija.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për zbatimin e masave mbrojtëse të shëndetit të bimëve ndaj sëmundjeve, dëmtuesve dhe barishteve të këqija, fillimisht në mbikëqyrje dhe pastaj në mënyrë të pavarur.
- Nxënësit duhet të përfshihen në kryerjen e llogaritjeve të thjeshta ekonomike të punimeve për zbatimin e masave mbrojtëse të shëndetit të bimëve.

-
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë dhe përdorimin e mirëmbajtjen e veglave dhe mjeteve që përdoren për kryerjen e e masave mbrojtëse të shëndetit të bimëve ndaj sëmundjeve, dëmtuesve dhe barishteve të këqija.
 - Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit gjatë kryerjes së masave mbrojtëse të shëndetit të bimëve ndaj sëmundjeve, dëmtuesve dhe barishteve të këqija.
 - Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike të punimeve për zbatimin e masave mbrojtëse të shëndetit të bimëve ndaj sëmundjeve, dëmtuesve dhe barishteve të këqija, si dhe për llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me këto punime.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohet mjedisi për krijimin e kopshtit, veglat, pajisjet, dhe baza materiale e mëposhtme.

- Ferma/baza prodhuese e shkollës.
 - Uniforma dhe pajisjet mbrojtëse për trajtimet kimike.
 - Komplet i veglave të punës të prodhimit bimor.
 - Katalogë sëmundjesh, dëmtuesish dhe barishtesh të këqija.
 - Pesticide të ndryshme.
 - Pompë spërkatëse.
 - Enë të ndryshme për përgatitjen e tretësirave kimike
 - Ujë të bollshëm
 - Pajisje kancelarie.
 - Makina llogaritëse dore.
 - Manualet e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos.
 - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e punimeve të mbrojtjes së shëndetit të bimëve (kodi i punës, legjislacioni fiskal).
 - Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal.
-

3. Moduli “Zbatimi i planit të prodhimit bimor në fushë”

Drejtimi.	Bujqësi
Profili.	Prodhim bimor
Niveli.	II
Klasa.	12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	ZBATIMI I PLANIT TË PRODHIMIT BIMOR NË FUSHË	M-14-944-13
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për të zbatuar planin e prodhimit bimor në fushë duke filluar nga plani i përgatitjes së tokës , i mbjelljeve, i përkujdesjeve të bimëve menjëherë pas mbjelljes, i plotësimit të nevojave për elementë ushqyes, i mbrojtjes së shëndetit të bimëve deri te zbatimi i planit të mbledhjes/vjeljes së prodhimit bimor dhe llogaritjet e thjeshta ekonomike që lidhen me këto punime.	
Kohëzgjatja e modulit	120 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor “Bujqësi”, si dhe modulën “Përdorim i veglave dhe mjeteve të prodhimit bimor”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi zbaton planin e punimeve të përgatitjes së tokës për mbjellje. Përmbajtja. <ul style="list-style-type: none">– Dhënie udhëzimesh për zbrëthimin e planit të punimeve të përgatitjes së tokës për mbjellje.– Zbrëthimi i planit të punimeve të përgatitjes së tokës për mbjellje.– Përcaktimi i sipërfaqes së tokës për mbjellje.– Përzgjedhja e veglave, pajisjeve dhe materialeve të punës për përgatitjen e tokës për mbjellje.– Transporti i mjeteve dhe veglave të punës.– Përcaktimi i strukturës së mbjelljes.– Pastrimi dhe sistemimi i tokës.– Punimi bazë dhe plotësues i tokës.– Plehërimi bazë dhe plotësues i tokës.– Ndarja e tokës në ngastra.– Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së tokës për mbjellje. Instrumentet e vlerësimit. <ul style="list-style-type: none">– Pyetje – përgjigje me gojë.– Diskutime– Vëzhgim me listë kontrolli. Kriteret e vlerësimit.	

Nxënësit duhet të jenë të aftë.

- Të njihet me mënyrën dhe modelet e zërthimit të planit të punimeve të përgatitjes e tokës për mbjellje.
- Të zërthejë planin e punimeve të përgatitjes së tokës për mbjellje, sipas udhëzimeve të dhëna.
- Të përcaktojë sipërfaqen e tokës për mbjellje, sipas kushteve dhe mundësive që ka shkolla apo lokaliteti përreth.
- Të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme për përgatitjen e tokës për mbjellje.
- Të transportojë me kujdes veglat, pajisjet dhe materialet e punës të përgatitjes së tokës për mbjellje.
- Të përcaktojë strukturën e mbjelljes së bimëve. monokulturë, bashkëshoqërim, me alternim etj.
- Të pastrojë tokën nga gurët apo mbetjet e forta bimore, dhe sistemojë atë duke hapur kanalet kulluese dhe ujtitëse të saj.
- Të kryejë punimet bazë (plugim) dhe punimet plotësuese si diskim, frezim, lesim, branim, etj., sipas tipit të tokës dhe llojit të kulturës që do të mbillet.
- Të kryejë plehërimin bazë dhe plotësues të tokës, sipas nevojës së dalë nga analizat kimike të saj.
- Të realizojë ndarjen e tokës në ngastra, sipas modelit të mbjelljes, llojit të kulturës dhe kushteve të zonës.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së tokës për mbjellje.

RM 2 Nxënësi zbaton planin e mbjelljeve të bimëve në fushë.

Përmbajtja.

- Dhënie udhëzimesh për zërthimin e planit të mbjelljeve të bimëve në fushë.
- Zërthimi i planit të mbjelljeve.
- Përlllogaritja e dendësisë së mbjelljes.
- Përlllogaritja e sasisë së materialit për mbjellje.
- Sigurimi i materialit për mbjellje.
- Përgatitja e materialit për mbjellje.
- Piketimi i ngastrave për mbjellje.
- Mbjellja e materialit fillestar në fushë.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë mbjelljes së bimëve në fushë.

Instrumentet e vlerësimit.

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit.

Nxënësit duhet të jenë të aftë.

- Të njihet me mënyrën dhe modelet e zërthimit të planit të realizimit të mbjelljeve të bimëve në fushë.
- Të zërthejë planin e mbjelljeve të fushës sipas udhëzimeve përkatëse.

- Të përlllogaritë dendësisë e mbjelljes, sipas distancave e mënyrës së mbjelljes, si dhe të llojit të kulturës.
- Të përlllogaritë sasisë e nevojshme të materialit mbjellës si farë, fidanë, bulb, copa etj., sipas llojit të kulturës dhe sipërfaqes së parcelës.
- Të sigurojë sasinë e përlllogaritur të materialit për mbjellje.
- Të përgatitë materialin për mbjellje, sipas llojit të tij si. dezinfektimi paraprak i farës, zbutja në ujë e farës, shkurtimi i rrënjëve të fidanit, bajgëzimi i fidanit, prerja e dezinfektimi i sipërfaqes së prerë të copave etj., në varësi të llojit të materialit mbjellës.
- Të kryejë piketimin e saktë të ngastrave sipas distancave të mbjelljes.
- Të realizojë mbjelljen sipas distancave të caktuara të mbjelljes.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë mbjelljes së bimëve në fushë.

RM 3 Nxënësi zbaton planin e përkujdesjeve të bimëve menjëherë pas mbjelljes në fushë.

Përmbajtja.

- Dhënie udhëzimesh për zbërthimin e planit të përkujdesjeve të bimëve menjëherë pas mbjelljes.
- Zbërthimi i planit të përkujdesjeve të bimëve menjëherë pas mbjelljes.
- Ujitja e menjëherëshme pas mbjelljes.
- Kontrolli i mbirjes së farave apo zënies së fidanëve/copave.
- Rrallimi i bimëve pas mbirjes.
- Zëvendësimi i vendeve bosh apo i fidanëve/copave të pa zëna.
- Plotësimi i nevojave të bimëve për elemente ushqyes.
- Vendosja e sistemit mbështetës bimëve të sapo mbira/zëna.
- Kontrolli i vazhdueshëm për sëmundje a dëmtues.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë përkujdesjes së bimëve menjëherë pas mbjelljes në fushë.

Instrumentet e vlerësimit.

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit.

Nxënësit duhet të jenë të aftë.

- Të njihet me mënyrën dhe modelet e zbërthimit të planit të përkujdesjeve të bimëve menjëherë pas mbjelljes.
- Të zbërthejë planin e përkujdesjeve të bimëve në fushë, sipas udhëzimeve përkatëse.
- Të kryejë ujitjen e menjëherëshme pas mbjelljes, në

- varësi të kushteve të mjedisit, nevojës së bimës për lagështirë (ujë).
- Të kontrollojë mbirjen e farave apo zënien e fidanëve apo copave të mbjella, sipas llojit të bimës dhe mënyrës së shtimit të saj.
 - Të kryejë rrallimin e bimëve pas mbirjes duke marrë në konsideratë sigurimin e numrit të bimëve për ha/m², sipas llojit të bimës.
 - Të zëvendësojë vendet bosh të bimëve të mbira nga fara, fidanët apo copat e pa zëna, sipas llojit të bimës dhe mënyrës së shtimit të saj, duke respektuar numrin e bimëve për ha/m².
 - Të plotësojë nevojat e bimëve për elemente ushqyes si N, P, K e mokrielementë të tjerë duke përdorur plehra të ndryshme organike, kimike dhe mikroplehra, sipas nevojave dhe fazave të rritjes e zhvillimit të bimës.
 - Të vendosë sistem mbështetës bimëve të sapo mbira/zëna, sipas llojit të bimës.
 - Të kontrollojë në mënyrë të vazhdueshme bimët e reja për sëmundje a dëmtues, sipas llojit të bimës dhe kushteve të zonës.
 - Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë përkujdesjes së bimëve menjëherë pas mbjelljes në parcelë.

RM 4 Nxënësi zbaton planin e masave të plotësimit të nevojave të bimëve për elemente ushqyes dhe ujë në fushë.

Përmbajtja.

- Dhënie udhëzimesh për zbërthimin e planit të masave të plotësimit të nevojave të bimëve për elementë ushqyes dhe ujë në fushë.
- Zbërthimi i planit të të masave të plotësimit të nevojave të bimëve për elementë ushqyes dhe ujë në fushë.
- Përcaktimi i nevojave të bimëve për elemente ushqyes.
- Përcaktimi i llojit të plehrave për plotësimin e nevojave të bimëve për elemente ushqyes.
- Përcaktimi i metodës së shpërndarjes së plehrave.
- Plotësimi i nevojave për makroelementë të bimëve.
- Plotësimi i nevojave për mikroelementë të bimëve.
- Llogaritja e nevojave të bimës për ujë.
- Përcaktimi i metodës/sistemit të ujitjes së bimëve.
- Plotësimi i nevojave të bimës për ujë.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë plotësimit të nevojave ushqimore të bimëve në fushë.

Instrumentet e vlerësimit.

- Pyetje-përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit.

Nxënësit duhet të jenë të aftë.

- Të njihet me mënyrën dhe modelet e zbërthimit të planit të përkujdesjeve të bimëve menjëherë pas mbjelljes.
- Të zbërthejë planin e përkujdesjeve të bimëve në fushë, sipas udhëzimeve përkatëse.
- Të përcaktojë nevojat e bimës për elemente ushqyes, sipas përbërjes së tokës, llojit të bimës dhe sipërfaqes së mbjellë.
- Të përcaktojë llojet e plehrave për plotësimin e nevojave të bimës për elemente ushqyes, si llojin e plehrit organik, llojet e plehrave kimike bazë, mikroplehrave dhe plehtrat e lëngshme.
- Të përcaktojë metodën më efektive të shpërndarjes së plehrave, në varësi të bimës dhe kushteve që ofron zona (me krah, me mjete mekanike etj).
- Të plotësojë nevojat e bimës për makroelementë, me anë të përdorimit të plehrit organik e kimik, sipas mundësive që ofron zona dhe kërkesave të bimës në faza të ndryshme të rritjes e zhvillimit të saj.
- Të plotësojë nevojat e bimës për mikroelementë, me përdorimin e mikroplehrave, plehrave të lëngshme etj., sipas kërkesave të bimës.
- Të llogaritë nevojat për ujë të bimës sipas fazave të rritjes e zhvillimit të tyre dhe kushteve të zonës.
- Të përcaktojë metodën/sistemin më efikas të plotësimit të nevojave të bimëve për ujë si, me brazda, me rrëshqitje, në formë shiu, me pika, me kova, me gropa etj.
- Të plotësojë nevojat për ujë të bimëve, sipas fazave të rritjes e zhvillimit të tyre dhe kushteve që ofron zona.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë zbatimit të masave të plotësimit të nevojave të bimëve për elementë ushqyes dhe ujë në fushë.

RM 5 Nxënësit zbaton planin e masave mbrojtëse të shëndetit të bimëve në fushë.

Përmbajtja.

- Dhënie udhëzimesh për zbërthimin e planit të masave të mbrojtjes së shëndetit të bimëve në fushë.
- Identifikimi i bimëve të prekura nga sëmundje.
- Përcaktimi i llojit të sëmundjes së bimëve.
- Zbërthimi i planit të masave mbrojtëse të shëndetit të bimëve nga sëmundja.
- Zbatimi i planit të masave të mbrojtjes së bimëve nga sëmundja.
- Identifikimi i bimëve të prekura nga dëmtues.
- Përcaktimi i llojit të dëmtuesit të bimëve.
- Zbatimi i planit të masave të mbrojtjes së shëndetit të bimëve nga dëmtuesi.
- Identifikimi i barishteve të këqija në fushën e mbjellë.
- Zbërthimi i masave mbrojtëse të shëndetit të bimëve nga

barishtet e këqija.

- Llogaritje të thjeshta të dëmit agronomik e ekonomik të shkaktuar nga sëmundje, dëmtues e barishte të këqija.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë zbatimit të planit të masave mbrojtëse të shëndetit të bimëve në fushë.

Instrumentet e vlerësimit.

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit.

Nxënësit duhet të jenë të aftë.

- Të njihet me mënyrën dhe modelet e zbrërthimit të planit të masave të mbrojtjes së shëndetit të bimëve në fushë.
- Të identifikojë bimët e sëmura, sipas simptomave të shfaqura dhe llojit të bimës.
- Të përcaktojë llojin e sëmundjes dhe dëmtuesve të bimëve, sipas simptomave të shfaqura.
- Të zbrërthejë planin e masave mbrojtëse të shëndetit të bimëve nga sëmundja dhe dëmtuesi, sipas llojit të tyre dhe kushteve të zonës.
- Të zbatojë planin e masave të mbrojtjes së bimëve nga sëmundja dhe dëmtuesi, sipas udhëzimeve përkatëse.
- Të identifikojë llojet e barishteve të këqija në fushën e mbjellë.
- Të zbrërthejë masat mbrojtëse të shëndetit të bimëve nga barishtet e këqija, sipas udhëzimeve përkatëse.
- Të kryejë llogaritje të dëmit agronomik dhe ekonomik të shkaktuar nga sëmundje, dëmtues e barishte të këqija.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë zbatimit të planit të masave mbrojtëse të shëndetit të bimëve në fushë.

RM 6 Nxënësit zbaton planin e mbledhjes/vjeljes së prodhimit bimor në fushë.

Përmbajtja.

- Dhënie udhëzimesh për zbrërthimin e planit të masave të mbledhjes/vjeljes së prodhimit bimor.
- Përcaktimi i kohës së mbledhjes/vjeljes së prodhimit bimor.
- Kontrolli i pjekurisë së prodhimit bimor.
- Trajtimet para mbledhjes/vjeljes së prodhimit bimor.
- Zbatimi i teknikave të mbledhjes/vjeljes së prodhimit bimor.
- Ndarja/klasifikimi i prodhimit bimor në fushë.
- Transporti i prodhimit bimor të mbledhur/vjelur.
- Peshimi i sasisë së prodhimit bimor.
- Magazinimi i prodhimit bimor.
- Kujdesi gjatë ruajtjes së prodhimit bimor.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të ruajtjes së

mjedisit gjatë zbatimit të planit të mbledhjes/vjeljes së prodhimit bimor në fushë.

Instrumentet e vlerësimit.

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit.

Nxënësi duhet të jenë të aftë.

- Të njihet me mënyrën dhe modelet e zërthimit të planit të mbledhjes/vjeljes së prodhimit bimor në fushë.
- Të përcaktojë kohën mbledhjes/vjeljes së prodhimit bimor, sipas llojit të kulturës dhe drejtimit ekonomik të prodhimit.
- Të kontrollojë vazhdimisht shenjat e pjekurisë së prodhimit bimor, sipas drejtimit të prodhimit, llojit të kulturës dhe kushteve të zonës.
- Të kryejë sipas nevojës trajtimet para mbledhjes/vjeljes së prodhimit bimor.
- Të mbledhë/vjelë prodhimin bimor duke zbatuar teknika të larmishme të mbledhjes/vjeljes, në varësi të kulturës dhe kushteve të zonës.
- Të ndajë/klasifikojë prodhimin bimor sipas standardit të kërkuar në përputhje me drejtimin e prodhimit.
- Të transportojë prodhimin bimor të mbledhur/vjelur sipas kushteve teknike të kërkuara për transportin e tyre, në varësi të llojit të prodhimit.
- Të peshojë saktë sasisë e prodhimit bimor të mbledhur - vjelë.
- Të magazinojë prodhimin bimor duke plotësuar dokumentacionin përkatës.
- Të kujdeset në mënyrë të vazhdueshme për ruajtjen e prodhimit bimor duke siguruar kushte e duhura për ruajtjen e tij, sipas llojit të prodhimit.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë zbatimit të planit të mbledhjes-vjeljes së prodhimit bimor në fushë.

RM 7 Nxënësit kryejnë llogaritje të thjeshta ekonomike të zbatimit të planit të masave të prodhimin bimor.

Përmbajtja.

- Kostot për zbatimin e planit të masave për prodhimin bimor.
- Preventivi i materialeve, kostoja për materialet.
- Kostoja e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.).
- Kosto të tjera (transport dhe makineri).
- Të ardhurat, fitimi, llogaritja e fitimit në zbatimin e masave për prodhimin bimor.

Instrumentet e vlerësimit.

- Pyetje-përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit.

Nxënësit duhet të jenë të aftë.

- të njehsojnë kostot për zbatimin e masave për prodhimin bimor.
- të njehsojnë preventivin e materialeve dhe koston e tyre, sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë koston e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.), sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë kostot e tjera (transport dhe makineri), sipas manualit përkatës.
- të llogaritin të ardhurat dhe fitimin në zbatimin e masave të prodhimit bimor.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në fermën e shkollës ose në fermë të prodhimit bimor pranë saj.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrime konkrete të zbatimit të masave për prodhimin bimor si: përgatitjen e tokës, mbjelljen, përkujdesjet menjëherë pas mbjelljes, plotësimin e nevojave për elementë ushqyese, mbrojtjen e shëndetit të bimëve, mbledhjen, vjeljen e prodhimit bimor, si dhe llogaritjet e thjeshta ekonomike që lidhen me këto procese.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për zbatimin e masave për prodhimin bimor si: përgatitjen e tokës, mbjelljen, përkujdesjet menjëherë pas mbjelljes, plotësimin e nevojave për elementë ushqyese, mbrojtjen e shëndetit të bimëve, mbledhjen, vjeljen e prodhimit bimor në fushë, fillimisht në mbikëqyrje dhe pastaj në mënyrë të pavarur.
- Nxënësit duhet të përfshihen në kryerjen e llogaritjeve të thjeshta ekonomike të proceseve të punës për prodhimin bimor.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë edhe përdorimin e mirëmbajtjen e veglave dhe mjeteve që përdoren për prodhimin bimor në fushë
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit gjatë punës për prodhimin bimor në fushë.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike të zbatimit të masave për prodhimin bimor si: përgatitjen e tokës, mbjelljen, përkujdesjet menjëherë pas mbjelljes, plotësimin e nevojave për elementë ushqyese, mbrojtjen e shëndetit të bimëve, mbledhjen, vjeljen e prodhimit bimor, si dhe të llogaritjeve të thjeshta ekonomike që lidhen me këto procese.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohet mjedisi për krijimin e kopshtit, veglat, pajisjet, dhe baza materiale e mëposhtme.
- Baza prodhuese e shkollës apo fermë e prodhimit bimor afër saj.
 - Traktor.
 - Vegla dhe pajisje pune për përgatitjen e tokës për mbjellje.
-

-
- Vegla dhe pajisje pune për mbjelljen e tokës.
 - Plehra organike e kimike.
 - Pajisje për ujitje, plehërime, spërkatje, vjelje etj.
 - DVD, video, CD, pankarka, skica apo modele të planit të prodhimit bimor në fushë.
 - Pajisje kancelarie.
 - Makina llogaritëse dore.
 - Manualët e preventivimit dhe për zberthimin e kostos.
 - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e prodhimit bimor (kodi i punës, legjislacioni fiskal).
 - Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal.
-

4. Moduli “Vlerësimi i materialit bimor për prodhimtari”

Drejtimi: Bujqësi
Profili: Prodhim bimor
Niveli: II
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kod	VLERËSIMI I MATERIALIT BIMOR PËR PRODHIMTARI	M-14-945-13
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për të kryer analizën biometrike në laborator, për kulturën e grurit dhe misrit për prodhimtari, si dhe në llogaritjet e thjeshta ekonomike që lidhen me to.	
Kohëzgjatja e modulit	84 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor “Bujqësi”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi kryen marrjen e mostrave për analizë.</p> <p><i>Përmbajtja.</i></p> <ul style="list-style-type: none">– Njesimi i preventivit të materialeve, koston për materialet.– Përzgjedhja e veglave, mjeteve dhe materialeve për kryerjen e analizës biometrike në kulturën e grurit.– Përcaktimi i fushës për marrjen e mostrës.– Përcaktimi i momentit të marrjes së mostrave.– Marrja e mostrës në pika të ndryshme të parcelës.– Etiketimi i mostrave.– Transportimi i mostrave në laborator.– Sistemimi i mostrave në laborator.– Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së analizës biometrike në kulturën e grurit. <p><i>Instrumentet e vlerësimit.</i></p> <ul style="list-style-type: none">– Pyetje – përgjigje me gojë.– Vëzhgim me listë kontrolli. <p><i>Kriteret e vlerësimit.</i></p> <p>Nxënësi duhet të jenë të aftë.</p> <ul style="list-style-type: none">– Të njesojë preventivin e materialeve dhe koston për materialet.– Të përzgjedhë veglat, mjetet e nevojshme për marrjen e mostrave për analizë.– Të përcaktojë fushën për marrjen e mostrave sipas mundësive që ofron zona.– Të përcaktojë momentin e duhur të marrjes së mostrave.	

-
- Të marrë mostrat për analizë në pika të ndryshme të parcelës sipas procedurës së caktuar.
 - Të etiketojë mostrat duke shënuar të dhënat përkatëse të kulturës: data e marrjes së mostrës, emri i kultivarit, numri i bimëve etj.).
 - Të transportojë me kujdes mostrat për analizë deri në laborator, për të eliminuar firot.
 - Të sistemojë mostrat në laborator në përputhje me kushtet teknike të ruajtjes së tyre.
 - Të zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë marrjes së mostrave për analizë.

RM 2 Nxënësi kryen analizën biometrike të mostrës së grurit për prodhimtari.

Përmbajtja.

- Përcaktimi numrit i vëllezërve në bimën e grurit.
- Përcaktimi i lartësisë së vëllait kryesor.
- Përcaktimi i gjatësisë së kallirit kryesor.
- Përcaktimi i kallëzave në kallirin kryesor.
- Përcaktimi i halëzimit dhe ngjyrës së kallirit.
- Përcaktimi i kokrrave në kallirin kryesor.
- Peshimi i kokrrave në kallirin kryesor.
- Peshimi i kokrrave të të gjithë bimës.
- Peshimi i 1000 ose 500 kokrrave.
- Mbajtja e shënimeve të përcaktimeve të mostrës së analizuar.
- Vlerësimi i prodhimtarisë në kulturën e grurit.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë vlerësimit të prodhimtarisë në kulturën e grurit me metodën laboratorike.

Instrumentet e vlerësimit.

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit.

Nxënësit duhet të jenë të aftë.

- Të përcaktojë saktë numrin e vëllezërve në bimën e grurit.
- Të përcaktojë saktë lartësisë së vëllait kryesor nga qafa e rrënjës deri në majën e kallirit kryesor.
- Të përcaktojë saktë gjatësisë së kallirit kryesor.
- Të përcaktojë saktë numrin e kallëzave në kallirin kryesor.
- Të përcaktojë halëzimin dhe ngjyrën e kallirit.
- Të përcaktojë saktë numrin e kokrrave në kallirin kryesor.
- Të peshojë me saktësi kokrrat e kallirit kryesor në peshore analitike.
- Të peshojë me saktësi kokrrat e të gjithë bimës, në peshore analitike.
- Të peshojë saktë masën e 1000 ose 500 kokrrave.
- Të mbajë shënim të gjithë përcaktimet që i bëhen mostrës

- së analizuar të grurit.
- Të vlerësojë prodhimtarinë e grurit me përafërsi, me anë të mesatares aritmetike.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë vlerësimit të prodhimtarisë së grurit me metodën biometrike.

RM 3 Nxënësi kryen analizën biometrike të mostrës së misrit për prodhimtari.

Përmbajtja.

- Përcaktimi i lartësisë së bimës së misrit.
- Përcaktimi i lartësisë së kallirit të parë nga toka.
- Përcaktimi i i bimëve shterpa.
- Përcaktimi i kallijve për bimë.
- Peshimi i kallirit.
- Përcaktimi i gjatësisë së kallirit.
- Numërimi i rreshtave në një kalli.
- Numërimi i kokrrave në rresht.
- Llogaritja e sasisë së kokrrave të kallirit.
- Shkoqja e kokrrave të kallirit.
- Peshimi i koçanit të kallirit.
- Peshimi i 1000 ose 500 kokrrave të misrit.
- Vlerësimi i prodhimtarisë së përafërt të misrit.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë vlerësimit të prodhimtarisë së misrit me metodën biometrike.

Instrumentet e vlerësimit.

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit.

Nxënësit duhet të jenë të aftë.

- Të përcaktojë saktë lartësinë e bimës së misrit, në cm nga toka deri në majën e melthit.
- Të përcaktojë saktë lartësinë e kallirit të parë nga toka.
- Të përcaktojë saktë numrin e bimëve shterpa.
- Të përcaktojë saktë numrin e kallijve për bimë.
- Të peshojë me saktësi kallirin e misrit.
- Të përcaktojë saktë gjatësinë e kallirit të misrit.
- Të numërojë saktë rreshtat në një kalliri misri.
- Të numërojë saktë kokrrat në një rresht.
- Të llogarisë saktë numrin e kokrrave të kallirit.
- Të shkoqë me kujdes, kokrrat e misrit të kallirit.
- Të peshojë saktë koçanin e kallirit.
- Të peshojë saktë masën e 1000 ose 500 kokrrave të misrit.
- Të vlerësojë prodhimtarinë e misrit me përafërsi, me anë të mesataren aritmetike.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë vlerësimit të prodhimtarisë së misrit me

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në ngastra të vogla në bazën prodhuese të shkollës ose në zonat përreth dhe në laboratorin e shkollës.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrime konkrete të proceseve të punës për vlerësimin e materialit bimor për prodhimtari me anë të metodës biometrike në kulturën e grurit dhe misrit.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për vlerësimin e materialit bimor për prodhimtari me anë të metodës biometrike në kulturën e grurit dhe misrit.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë përdorimin dhe mirëmbajtjen e veglave, mjeteve dhe materialeve që përdoren për vlerësimin e materialit bimor për prodhimtari me anë të metodës biometrike në kulturën e grurit dhe misrit.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit gjatë vlerësimin e materialit bimor për prodhimtari me anë të metodës biometrike në kulturën e grurit dhe misrit.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për vlerësimin e materialit bimor për prodhimtari me anë të metodës biometrike në kulturën e grurit dhe misrit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohet ngastra e tokës bujqësore, veglat, pajisjet, dhe makineria e mëposhtme.
- Ngastër toke në bazën prodhuese të shkollës apo fermë bujqësore të mbjella me grurë dhe misër.
 - Vegla dhe pajisje pune të vlerësimit të materialit bimor për prodhimtari të tilla si. metër druri, vizore milimetrike, peshore analitike, shosha, pjata për vendosjen e prodhimit të çdo bime, zarfa , laps dhe letër për shënime, fletore pune etj..
 - Pankarta, skica, udhëzues, katalogë, rregullore, etj.
 - Pajisje kancelarie.
 - Makina llogaritëse dore.
-

X. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar

1. Moduli “Analiza e cilësive të farës për mbjellje“

Drejtimi.	Bujqësi
Profili.	Prodhim bimor
Niveli.	II
Klasa.	12

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	ANALIZA E CILËSIVE TË FARËS PËR MBJELLJE	M-14-946-13
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për të përgatitur farën për analizë, analizuar pastërtinë mekanike, fuqinë dhe energjinë mbirëse të saj.	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor “Bujqësi”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi përgatit farën për analizë. Përmbajtja. <ul style="list-style-type: none">– Veshja e uniformës së punës.– Njesimi i preventivit të materialeve dhe kostot për materialet.– Përzgjedhja e mjeteve dhe materialeve për përgatitjen e farës për analizë– Përgatitja e mjeteve dhe materialeve për përgatitjen e farës për analizë.– Përzgjedhja e kulturave për analizim fare.– Sigurimi i larmisë dhe sasisë së farave.– Marrja e mostrës së farës për analizë.– Etiketimi i mostrave për secilin lloj fare.– Transporti i mostrave të farës.– Hapja e mostrave të farës.– Zbatimi i rregullave e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së farës për analizë. Instrumentet e vlerësimit. <ul style="list-style-type: none">– Pyetje – përgjigje me gojë.– Vëzhgim me listë kontrolli. Kriteret e vlerësimit. <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë.</p> <ul style="list-style-type: none">– Të veshë uniformën e duhur të punës për përgatitjen e farës për analizë.	

-
- Të njesojë preventivin e materilave dhe kostot për materialet e nevojshme për kryerjen e analizës së farës.
 - Të përzgjedhë mjetet dhe materialet për përgatitjen e farës për analizë si: fara të kulturave të ndryshme, peshore me gurë deri në miligram peshe, letër të bardhë, pambuk etj.
 - Të përgatitë mjetet dhe materialet e punës për përgatitjen e farës për analizë.
 - Të përzgjedhë llojet e kulturave për analizën e farës së tyre si grurë, misër, jonxhë etj .
 - Të sigurojë larminë dhe sasisë e nevojshme të farave sipas kulturave të përzgjedhura dhe mundësive që ofron zona.
 - Të marrë mostrat e farës për analizë në peshën 50 gr për çdo lloj kulture.
 - Të etiketojë të gjitha mostrat e farës sipas kulturës së përzgjedhur me të gjitha të dhënat përkatëse si. data e marrjes, lloji i farës, vendi ku është marrë mostra dhe viti i riprodhimit të fares etj.
 - Të transportojë pa dëmtuar mostrat e fares për analizë në laborator apo klasë.
 - Të hapë mostrat e farës mbi një letër të bardhë apo celefon të pastër.
 - Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së farës për analizë.

RM 2 Nxënësi analizon pastërtinë e farës.

Përmbajtja.

- Përgatitja e mjeteve për analizën e pastërtisë së farës.
- Veçimi i lëndëve të huaja pa jetë nga farat.
- Peshimi dhe llogaritja në % e sasisë së lëndëve të huaja pa jetë.
- Veçimi i lëndëve të huaja me jetë nga farat.
- Peshimi dhe llogaritja në % e sasisë së lëndëve të huaja me jetë.
- Veçimi i farave të pazhvilluara mirë.
- Peshimi dhe llogaritja në % e sasisë së farave të pazhvilluara mirë.
- Veçimi i farave të plota dhe të shëndetshme.
- Peshimi dhe llogaritja në % e sasisë së farave të plota e të shëndetshme.
- Përcaktimi i pastërtisë së farës dhe klasën e saj.
- Krahasimi i rezultatit me rezultatet standard.
- Vlerësimi i farës për mbjellje ose jo.
- Zbatimi i rregullave e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë analizës së pastërtisë së farës për mbjellje.

Instrumentet e vlerësimit.

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit.

Nxënësi duhet të jetë i aftë.

- Të përgatitë mjetet e nevojshme për analizën e pastërtisë mekanike të fares për mbjellje.
- Të veçojë lëndët e huaja pa jetë nga farat si: kashtë, hala, pluhur, fara të coptuara e të dëmtuara etj.
- Të peshojë dhe llogaritë saktë në % sasinë e lëndëve të huaja pa jetë.
- Të veçojë lëndët të huaja me jetë nga farat si: fara të bimëve të tjera elb, thekër, farat e barishteve të këqija, dëmtuesit e gjallë dhe larvat e tyre etj.
- Të peshojë dhe llogaritë saktë në % sasinë së lëndëve të huaja me jetë.
- Të veçojë farat e pazhvilluara mire si: ato me embrion jo të plotë, të mpita dhe me endospermë të dëmtuar pjesërisht.
- Të peshojë dhe llogaritë saktë në % sasisë së farave të pazhvilluara mirë.
- Të veçojë me kujdes farat e plota dhe të shëndetshme.
- Të peshojë dhe llogaritë saktë në % sasinë e farave të plota dhe të shëndetshme.
- Të përcaktojë pastërtinë e farës dhe klasën e saj, sipas llojit të farës.
- Të krahasojë rezultatin e analizës me rezultatet e tabelës së klasifikimit të farave.
- Të vlerësojë farën për mbjellje ose jo, duke iu referuar standardit të farave.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë analizës së pastërtisë së farës për mbjellje.

RM 3 Nxënësi analizon energjinë dhe fuqinë mbirëse të farës.

Përmbajtja.

- Përgatitja e mjeteve për analizën e energjisë dhe fuqisë mbirëse të farës.
- Marrja e mostrës për 4 prova analize.
- Njomja e mostrës së fares me ujë.
- Vendosja e mostrës së farës në shtrat me rërë ose letër thithëse në pjata.
- Vendosja e mostrës së farës në dollap ose termostat në temperature të përshtatshme.
- Mbajtja e farave të vendosura në dollap.
- Përcaktimi i energjisë mbirëse të farës.
- Mbajtja e farave të vendosura në dollap për përcaktimin e fuqisë mbirëse.
- Përcaktimi i fuqisë mbirëse të fares.
- Vlerësimi i farës për mbjellje.
- Zbatimi i rregullave e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë analizës së energjisë dhe fuqisë mbirëse të farës për mbjellje.

Instrumentet e vlerësimit.

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit.

Nxënësi duhet të jetë i aftë.

- Të përgatitë mjetet e nevojshme për analizën e energjisë dhe fuqisë mbirëse të farës për mbjellje.
- Të marrë mostrat e farës për 4 prova analize: farat e mëdha me nga 100 fara, të voglat me 50 fara.
- Të njomë mostrat e farës me ujë, për mbirje.
- Të vendosë mostrën e farës në shtrat me rërë ose letër thithëse në pjata sipas kriterëve të përcaktuara për mbirje.
- Të vendosë në dollap ose në termostat në temperaturë të caktuar, mostrat e farës, për çdo lloj bime.
- Të mbajë mostrat e farave në dollap për 3-4 ditë për të përcaktuar energjinë mbirëse.
- Të përcaktojë energjinë mbirëse të farës duke nxjerrë pjatat nga dollapi dhe numëruar farat e mbira pas 3-4 ditësh.
- Të mbajë mostrat në dollap për 7-10 ditë për të përcaktuar fuqinë mbirëse të farës.
- Të përcaktojë fuqisë mbirëse duke e nxjerrë pjatat nga dollapi dhe numëruar farat e mbira me kujdes.
- Të vlerësojë farën për mbjellje ose jo duke u bazuar në rezultatet e analizës.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë analizës së energjisë dhe fuqisë mbirëse të farës për mbjellje.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në laboratorin e shkollës ose në klasë.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrime konkrete të proceseve të punës për përgatitjen e farës për analizë, analizën e pastërtisë mekanike, energjisë dhe fuqisë mbirëse të farës për mbjellje.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për përgatitjen e farës për analizë, analizën e pastërtisë, energjisë dhe fuqisë mbirëse të farës për mbjellje.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë përdorimin dhe mirëmbajtjen e veglave, mjeteve dhe materialeve të përgatitjes së farës për analizë, analizën e pastërtisë, energjisë dhe fuqisë mbirëse të farës për mbjellje.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së farës për analizë, analizën e pastërtisë, energjisë dhe fuqisë mbirëse të farës për mbjellje.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës të përgatitjes së e farës për analizë, analizën e pastërtisë, energjisë dhe fuqisë mbirëse të farës për mbjellje.

**Kushtet e
e domosdoshme
për realizimin e
modulit**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme.

- Laboratori me pajisjet e duhura për analizën e farës.
 - Pjata me letër thithëse.
 - Rërë.
 - Fara të kulturave të ndryshme.
 - Dollap, termostat.
 - Pajisje kancelarie.
 - Makina llogaritëse dore.
 - Pankarta, tabela apo katalogë të klasifikimit të farave për mbjellje etj.
-

2.Moduli “Përpunimi i farave të lulediellit për prodhimin e vajit”

Drejtimi.	Bujqësi
Profili.	Prodhim bimor
Niveli.	II
Klasa.	12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PËRPUNIMI I FARAVE TË LULEDIELLIT PËR PRODHIMIN E VAJIT	M-08-026-12
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që aftëson nxënësit për të kryer veprimtari pune ndihmëse për përpunimin e farave të lulediellit, prodhimit të vajit të lulediellit me ekstraktim, prodhimit të vajit të lulediellit me presim, si dhe ambalazhimin dhe ruajtjen e vajit të lulediellit.	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësi duhet të ketë përfunduar nivelin I të drejtimin mësimor “Bujqësi”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi kryen procese përgatitore për përpunimin e farave të lulediellit për vaj.</p> <p>Përmbajtja.</p> <ul style="list-style-type: none">– Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës.– Higjienizimi i vendit dhe i mjeteve të punës.– Transportimi i farave të lulediellit në repartin e përgatitjes së lëndës së parë.– Shtimi i farave të lulediellit në bunkerin e lëndës së parë.– Transportimi i farave të lulediellit në pajisjet tharëse.– Mbikqyrja e temperaturës, gjatë procesit të tharjes.– Transportimi i farave të lulediellit në pajisjen e pastrimit të farës.– Largimi i mbeturinave nga reparti.– Transportimi i farave të lulediellit në pajisjet copëtuese.– Pastrimi i vendit dhe mjeteve të punës.– Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë kryerjes së proceseve përgatitore të përpunimit të farave të lulediellit për prodhimin e vajit. <p>Instrumentet e vlerësimit.</p> <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli.– Pyetje-përgjigje me gojë. <p>Kriteret e vlerësimit.</p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë.</p> <ul style="list-style-type: none">– Të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për përpunimin e farave të lulediellit.– Të higjienizojë vendin dhe mjetet e punës, sipas rregullave	

higjiëno-sanitare.

- Të transportojë, me kujdes, farat e lulediellit në repartin e përgatitjes së lëndës së parë.
- Të furnizojë bunkerin me lëndës së parë, pa e derdhur atë.
- Të transportojë, me kujdes, farat e lulediellit në pajisjet tharëse.
- Të mbikqyrë, me kujdes, temperaturën gjatë procesit të tharjes, për mosndryshim të saj.
- Të transportojë, me kujdes, farat e lulediellit në pajisjet e pastrimit.
- Të largojë, me kujdes, mbeturinat nga reparti.
- Të transportojë, me kujdes, farat e lulediellit në pajisjet copëtuese.
- Të pastrojë vendin dhe mjetet e punës, duke respektuar rregullat higjiëno-sanitare.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit, gjatë përpunimit të farave të lulediellit për vaj.

RM 2 Nxënësi kryen procese përgatitore për prodhimin e vajit të lulediellit me ekstraktim.

Përmbajtja.

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës.
- Higjienizimi i vendit dhe i mjeteve të punës.
- Transportimi i farave të lulediellit të copëtuar në repart.
- Transportimi i tretësit në repart.
- Mbushja e ekstraktorëve me fara luledielli të copëtuar.
- Mbyllja e ekstraktorëve.
- Mbikqyrja e temperaturës gjatë procesit të distilimit të përzierjes vaj-tretës.
- Matja e nivelit të tretësit në rezervuar.
- Shkarkimi i bërsive nga ekstraktorët.
- Transportimi i bërsive nga reparti.
- Pastrimi i vendit dhe mjeteve të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë kryerjes së proceseve përgatitore për prodhimin e vajit të lulediellit me ekstraktim.

Instrumentet e vlerësimit.

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje-përgjigje me gojë.

Kriteret e vlerësimit.

Nxënësi duhet të jetë i aftë.

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës, për prodhimin e vajit me ekstraktim.
- të higjienizojë mjetet dhe mjedisin e punës, sipas kushteve higjiëno-sanitare.
- të transportojë, me kujdes, farat e lulediellit të copëtuar në repart.
- të transportojë, me kujdes, tretësin në repart.

- të mbushë, me kujdes, ekstraktorët me fara luledielli të copëtuara.
- të mbyllë hermetikisht ekstraktorët.
- të mbikqyrë temperaturën gjatë procesit të distilimit të përzierjes vaj-tretës, për të ruajtur temperaturën konstante.
- të masë, saktë, nivelin e tretësit në rezervuar.
- të shkarkojë, pa ndotur ambientin, bërsitë nga ekstraktorët.
- të transportojë, me kujdes, bërsitë nga reparti.
- të pastrojë vendin dhe mjetet e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit, gjatë kryerjes së proceseve të punës të prodhimit të vajit të lulediellit me ekstraktim.

RM 3 Nxënësi kryen procese përgatitore për prodhimin e vajit të lulediellit me presim.

Përmbajtja.

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës.
- Higjienizimi i vendit dhe mjeteve të punës.
- Transportimi i farave të lulediellit të copëtuara në repartin e presimit.
- Furnizimi i presës me fara luledielli të copëtuara.
- Shkarkimi i bërsive nga presa.
- Transporti i bërsive nga reparti.
- Pastrimi i vendit dhe mjeteve të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit.

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit.

Nxënësi duhet të jetë i aftë.

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për prodhimin e vajit të lulediellit me presim.
- të higjienizojë mjetet dhe mjedisin e punës sipas kërkesave higjieno-sanitare.
- të transportojë, me kujdes, farat e lulediellit të copëtuara në repartin e presimit.
- të furnizojë me shumë kujdes, presën me fara luledielli të copëtuara.
- të shkarkojë bërsitë nga presa, pa ndotur mjedisin ku punohet.
- të transportojë, me kujdes, bërsitë nga reparti në vendin e duhur.
- të pastrojë vendin dhe mjetet e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit, gjatë kryerjes së proceseve të punës për prodhimin të vajit të lulediellit me presim.

RM 4 Nxënësi kryen ambalazhimin dhe ruajtjen e vajit të lulediellit.

Përmbajtja.

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës.
- Higjienizimi i mjeteve dhe mjedisit të punës.
- Përgatitja e ambalazheve bosh për mbushje.
- Mbikqyrja e mbushjes së ambalazheve me vaj luledielli.
- Taposja e shisheve.
- Etiketimi i ambalazheve.
- Vendosja në kutitë e ambalazhit.
- Transporti i produktit të ambalazhuar në magazinë.
- Pastrimi i vendit dhe mjeteve të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit.

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje-përgjigje me gojë.

Kriteret e vlerësimit.

Nxënësi duhet të jetë i aftë.

- Të përgatisë vendin dhe mjetet e punës, për ambalazhimin dhe ruajtjen e vajit të ambalazhuar.
- Të higjienizojë mjetet dhe mjedisin e punës, sipas kërkesave higjiëno-sanitare.
- Të përgatisë ambalazhet bosh, për mbushje, sipas standardeve të kërkuara.
- Të mbikqyrë, me kujdes, mbushjen e ambalazheve me vaj luledielli.
- Të taposë, me kujdes, shishet.
- Të etiketojë ambalazhet me etiketat përkatëse, sipas kriterëve të marketingut.
- Të vendosë vajin e ambalazhuar në kuti, pa e dëmtuar.
- Të transportojë, me kujdes, produktin e ambalazhuar në magazinë.
- Të pastrojë vendin dhe mjetet e punës, duke respektuar rregullat higjiëno-sanitare.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë ambalazhimit dhe ruajtjes së vajit të lulediellit.

RM 5 Nxënësi kryen llogaritje të thjeshta ekonomike të përpunimit të farave të lulediellit për prodhimin e vajit.

Përmbajtja

- Kostot e përpunimit të farave të lulediellit për prodhimin e vajit, si dhe përbërësit e kostove.
- Preventivi i materialeve, kostoja për materialet.
- Kostoja e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.).
- Kosto të tjera (transport dhe makineri).
- Të ardhurat, fitimi, llogaritja e fitimit në një biznes të

vogël të përpunimit të farave të lulediellit për vaj.

Instrumentet e vlerësimit.

- Pyetje-përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit.

Nxënësi duhet të jenë të aftë.

- të njehsojë kostot e përpunimit të farave të lulediellit për prodhim vaji.
- të njehsojë preventivin e materialeve dhe koston e tyre, sipas manualit përkatës.
- të njehsojë koston e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.), sipas manualit përkatës.
- të njehsojë kostot e tjera (transport dhe makineri), sipas manualit përkatës.
- të llogarisë të ardhurat dhe fitimin në një biznes të vogël të përpunimit të farave të lulediellit për prodhim vaji.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në repartet e përpunimit të farave të lulediellit për prodhimin e vajit ose në frabrikë të prodhimit të vajit.
- Gjatë trajtimit të modulit instruktori i praktikës, ose teknologu i repartit duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrime konkrete të proceseve përgatitore të punës për përpunimin e farave të lulediellit, prodhimin të vajit të lulediellit me ekstraktim, prodhimin të vajit të lulediellit me presim, ambalazhimin dhe ruajtjes së vajit të lulediellit, si dhe llogaritjeve të thjeshta ekonomike lidhur me proceset e punës për prodhimin e vajit nga farat e lulediellit.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtaritë konkrete të punës për kryerjen e proceseve përgatitore për përpunimin e farave të lulediellit, prodhimin të vajit të lulediellit me ekstraktim, prodhimin të vajit të lulediellit me presim, ambalazhimin dhe ruajtjes së vajit të lulediellit, si dhe llogaritjeve të thjeshta ekonomike lidhur me proceset e punës për prodhimin e vajit nga farat e lulediellit
- Instruktori i praktikës ose teknologu i repartit duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së makinerive e pajisjeve.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike të përpunimit të farave të lulediellit për prodhimin e vajit, si dhe të llogaritjeve të thjeshta ekonomike lidhur me to.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme.
- Repart për prodhimin e vajit nga farat e lulediellit.
 - Mjete pune për prodhimin e vajit nga farat e lulediellit dhe ambalazhimin të tij.
-

-
- Lëndë të para për prodhimin e vajit të lulediellit.
 - skema, makete, udhëzuesa, katalog, rregullore, standarte shtetërore, etj.
 - Pajisje kancelarie.
 - Makina llogaritëse dore.
 - Manualet e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos.
 - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e përpunimit të farave për vaj (kodi i punës, legjislacioni fiskal).
 - Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal.
-

3. Moduli. “Ujitja e bimëve të arave dhe perimeve”

Drejtimi.	Bujqësi
Profili.	Prodhim bimor
Niveli.	II
Klasa.	12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	UJITJA E BIMËVE TË ARAVE E PERIMEVE	M-14-94713
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për kryerjen e ujitjes sipërfaqësore me brazda e rrëshqitje, me shihedhje dhe me pika, si dhe për llogaritjet e thjeshta ekonomike lidhur me kryerjen e ujitjeve të ndryshme në bimët e arave e perimeve në fermë.	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësi duhet të ketë përfunduar modulet e praktikës profesionale të drejtimit “Bujqësi”, niveli I.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësit kryejnë punime përgatitore për ujitjen me mënyra të ndryshme.</p> <p><i>Përmbajtja.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> – Përzgjedhja e veglave e pajisjeve për kryerjen e ujitjeve. – Përcaktimi i tokës së mbjellë për ujitje. – Transportimi i veglave dhe i pajisjeve të nevojshme. – Interpretimi dhe skicimi i skemave të ujitjes së tokës. – Përcaktimi i kohës dhe i mënyrës së ujitjes. – Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së punimeve përgatitore për ujitjen me mënyra të ndryshme. <p><i>Instrumentet e vlerësimit.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> – Vëzhgim me listë kontrolli <p><i>Kriteret e vlerësimit.</i></p> <p>Nxënësit duhet të jenë të aftë.</p> <ul style="list-style-type: none"> – të përzgjedhin veglat, pajisjet për kryerjen e ujitjeve sipas kulturës dhe mënyrës së ujitjes. – të përcaktojnë tokën e mbjellë për ujitje sipas kulturave. – të transportojnë veglat dhe pajisjet në vendin e caktuar. – të interpretojnë dhe skicojnë sipas skicave të gatshme skema për ujitjen e tokës. – të përcaktojnë kohën dhe mënyrën e duhur të ujitjes sipas llojit të kulturës, tipit dhe pjerrësisë së tokës bujqësore. – të zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë kryerjes së punimeve përgatitore për ujitjen me mënyra të ndryshme. 	

RM 2 Nxënësit kryejnë ujitje sipërfaqësore me brazda e rrëshqitje.

Përmbajtja.

- Përcaktimi i kulturës për ujitjen sipërfaqësore me
- brazda e rrëshqitje.
- Përcaktimi i gjerësisë dhe i largësisë së brazdave.
- Hapja e brazdave.
- Lëshimi i ujit në brazdë.
- Përcaktimi i kohës së qëndrimit të ujit në brazdë.
- Ndjekja e lëvizjes së ujit në brazdë.
- Kryerja e ujitjes sipërfaqësore me rrëshqitje.
- Kontrolli i cilësisë së ujitjes sipërfaqësore me brazda e rrëshqitje.
- Pastrimi dhe ruajtja e veglave dhe pajisjeve të ujitjes sipërfaqësore me brazda dhe rrëshqitje.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së ujitjes sipërfaqësore me brazda e rrëshqitje.

Instrumentet e vlerësimit.

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit.

Nxënësit duhet të jenë të aftë.

- të përcaktojnë kulturën që i përshtatet ujitjes sipërfaqësore me brazda e rrëshqitje.
- të përcaktojnë gjerësinë dhe largësinë e brazdave sipas llojit të tokës.
- të hapin brazdat duke zbatuar parametrat teknikë sipas përbërjes mekanike, pjerrësisë së tokës etj.
- të lëshojnë ujin në brazdë me një rrymë fillestare të caktuar për të mbërritur sa më shpejt në fund të saj.
- të përcaktojnë kohën e qëndrimit të ujit në brazdë sipas përbërjes grimcametrike të tokës.
- të ndjekin lëvizjen e ujit në brazdë sipas drejtimit të mbjelljes së bimëve.
- të kryejnë ujitjen sipërfaqësore me rrëshqitje sipas pjerrësisë së tokës.
- të kontrollojnë cilësinë e ujitjes sipërfaqësore me brazda e rrëshqitje për plotësimin e kërkesave teknike.
- të pastrojnë dhe ruajnë veglat dhe pajisjet për ujitjen sipërfaqësore me brazda dhe rrëshqitje.
- të zbatojnë rregullave e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së ujitjes sipërfaqësore me brazda e rrëshqitje.

RM3 Nxënësit kryejnë ujitjen me shihedhje.

Përmbajtja.

- Përzgjedhja e kulturës.
- Kontrolli i impiantit shihedhës.
- Montimi i impiantit ujitës.

- Lëshimi i ujit.
- Kontrolli i vazhdueshëm gjatë kryerjes së ujitjes.
- Çmontimi i impiantit ujitës.
- Pastrimi dhe ruajtja e impiantit ujitës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë kryerjes së ujitjes me shihedhje.

Instrumentet e vlerësimit.

- Pyetje-përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli i punës së bërë.

Kriteret e vlerësimit.

Nxënësit duhet të jenë të aftë.

- të përzgjedhin kulturën që i përshtatet ujitjes me shihedhje.
- të kontrollojnë impiantin shihedhës për funksionim të rregullt të tij.
- të montojnë impiantin ujitës sipas kërkesave teknike.
- të lëshojnë ujin në mënyrë të njëtrajtshme për mbulimin e të gjithë sipërfaqes.
- të kontrollojnë në mënyrë të vazhdueshme kryerjen e ujitjes për evitimin e rrjedhjeve nga tubacionet.
- të çmontojnë impiantin ujitës sipas kërkesave teknike.
- të pastrojnë dhe mirëmbajnë impiantin ujitës sipas kërkesave teknike.
- të zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë kryerjes së ujitjes me shihedhje.

RM 4 Nxënësit kryejnë ujitjen me pika.

Përmbajtja.

- Përzgjedhja e kulturës.
- Përzgjedhja e tubave, pikatoreve dhe transportimi i tyre.
- Montimi i pikatoreve në tubacione.
- Përcaktimi i normës së ujitjes.
- Lëshimi i ujit.
- Kontrolli i vazhdueshëm i ujitjes me pika.
- Çmontimi i pikatoreve.
- Pastrimi dhe ruajtja e pikatoreve.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë kryerjes së ujitjes me pika.

Instrumentet e vlerësimit.

- Pyetje-përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli i punës së bërë.

Kriteret e vlerësimit.

Nxënësit duhet të jenë të aftë.

- të përzgjedhin kulturën që i përshtatet ujitjes me pika.
- të përzgjedhin pikatoret e duhura në varësi të kulturës

- dhe t'i transportojnë ato.
- të montojnë pikatoret në tubacione sipas kushteve teknike.
 - të përcaktojnë normën e ujitjes sipas formulës së dhënë.
 - të lëshojnë ujin në mënyrë të njëtrajtshme për mbulimin e të gjithë sipërfaqes.
 - të kontrollojnë në mënyrë të vazhdueshme ujitjen me pika për evitimin e rrjedhjeve nga tubacionet.
 - të çmontojnë tubat e çmontueshëm dhe pikatoret sipas kushteve teknike.
 - të pastrojnë dhe mirëmbajnë pikatoret sipas kërkesave teknike.
 - të zbatojnë rregullat e sigurimin teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë ujitjes me pika.

RM 5 Nxënësi kryen llogaritje të thjeshta ekonomike të ujitjes së bimëve të arave dhe perimeve.

Përmbajtja

- Kostot e punimeve të ujitjes së bimëve të arave dhe perimeve, si dhe përbërësit e kostove.
- Preventivi i materialeve, kostoja për materialet.
- Kostoja e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.).
- Kosto të tjera (transport dhe makineri).

Instrumentet e vlerësimit.

- Pyetje-përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit.

Nxënësi duhet të jenë të aftë.

- të njehsojë kostot e punimeve të ujitjes së bimëve të arave dhe perimeve.
- të njehsojë preventivin e materialeve dhe koston e tyre, sipas manualit përkatës.
- të njehsojë koston e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.), sipas manualit përkatës.
- të njehsojë kostot e tjera (transport dhe makineri), sipas manualit përkatës.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në bazën prodhuese të shkollës ose në ferma bujqësore të cilat praktikojnë mënyra të ndryshme të ujitjes.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrime konkrete të proceseve të ujitjes sipërfaqësore me brazda e rrëshqitje, me shihedhje dhe me pika, si dhe të llogaritjeve të thjeshta ekonomike ludhur me to.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e veprimeve për ujitjen sipërfaqësore me brazda e rrëshqitje, me shihedhje dhe me pika, si dhe të llogaritjeve

të thjeshta ekonomike ludhur me to.

- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë përdorimin dhe mirëmbajtjen e veglave, mjeteve dhe impianteve për ujitjen sipërfaqësore me brazda e rrëshqitje, me shihedhje dhe me pika si dhe të llogaritjeve të thjeshta ekonomike ludhur me to.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së veglave, pajisjeve dhe impianteve.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për ujitjen sipërfaqësore me brazda e rrëshqitje, me shihedhje dhe me pika si dhe të llogaritjeve të thjeshta ekonomike ludhur me to.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen terreni, veglat dhe pajisjet e punës të mëposhtme.

- Skica të gatshme me skema për rrjetin e ujitjes sipërfaqësore me brazda, me shihedhje dhe me pika.
 - Impiant për ujitjen me shihedhje dhe me pika,
 - Tubacione, etj.
 - Pajisje kancelarie.
 - Makina llogaritëse dore.
 - Manualet e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos.
 - Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal.
-